

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 4-2020

Trajtimi Ligjor I Kriminalitetit Të Organizuar Dhe Format E Tij

Leorentë Alija

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

Recommended Citation

Alija, Leorentë, "Trajtimi Ligjor I Kriminalitetit Të Organizuar Dhe Format E Tij" (2020). *Theses and Dissertations*. 1957.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1957>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti Juridik

**TRAJTIMI LIGJOR I KRIMINALITETIT TË ORGANIZUAR DHE
FORMAT E TIJ**

Shkalla Bachelor

Leorentë Alija

Prill/2020
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti Juridik

Punim Diplome
Viti akademik 2015/2019

Leorentë Alija

**TRAJTIMI LIGJOR I KRIMINALITETIT TË ORGANIZUAR DHE
FORMAT E TIJ**

Mentori: Ph.D cand. Elmi Kelmendi

Prill/2020

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Qëllimi i kësaj teme është trajtimi i krimit të organizuar, rreziku dhe ndikimi i tij në shoqëri. Në këtë punim janë analizuar dhe prezentuar format e kriminalitetit të organizuar dhe trajtimi i këtyre formave në bazë të legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtarë. Lidhur me kriminalitetin e organizuar janë paraqitur nocione, teori të ndryshme dhe masa të ndryshme për parandalimin dhe trajtimin e tij.

Kriminaliteti i organizuar konsiderohet si një nga format më të shpeshta dhe më të rrezikshme të sjelljeve kriminale. Kjo dukuri negative e sjelljeve kriminale paraqitet pothuajse në çdo shtet, qoftë në shtete të zhvilluara apo edhe në ato shtete të pazhvilluara dhe mbi të gjitha kriminaliteti i organizuar prekë shtetin dhe rregullimin e tij juridik. Aktivitetet e krimit të organizuar janë pothuajse të pavërejtshme, sepse shumë grupe kriminale operojnë me mjete teknike tejet të sofistikuar, andaj për organet hetuese dhe ato të ndjekjes është e vështirë për t'i zbuluar dhe për t'i kapur, sepse nevojitet një bashkërenditje shumë serioze e angazhimit dhe veprimit të të gjithë faktorëve kompetentë.

Me qëllim të luftimit të kriminalitetit të organizuar si forma më e shpeshtë dhe më e rrezikshme janë paraqitur metoda të ndryshme për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit të organizuar. Për luftimin efikas të kriminalitetit të organizuar është e nevojshme që bashkësia ndërkombëtare të zhvillojë mjetet dhe metodat, për t'u ballafaquar me sukses me këto çështje të ndjeshme penale me qëllim të hetimit, zbulimit dhe kapjes së kryerësve të veprave penale të kryera në formë të krimit të organizuar. Kriminaliteti, pavarësisht nga veçoritë, nuancat, dinamika dhe shkalla e intensitetit, për të gjitha kohët ka si të përbashkët: dëmtimin, cënimin, shqetësimin që i sjellë individëve, grupimeve shoqërore apo shoqërisë në përgjithësi.

Fjalë Kyçe: *krim i organizuar, kriminalitet kibernetik, kontraband me narkotikë, parandalim, luftim, trajtim.*

MIRËNJOHJE/FALENDERIME

Fillimisht, jam falenderuese ndaj familjes time për dashurinë e tyre të pakushëzuar, për mirëkuptimin, mbështetjen, kujdesin, edukimin dhe përgaditjen time për të ardhmën. Falenderime të përjetëshme për inkurajimin e tyre ndaj meje dhe që gjithmonë ishin dora ime e djathtë. Shpresoj, që shumë shpejtë unë do të jem dora juaj e djathtë, gjithashtu.

Përveç kësaj, jam shumë mirënjohëse që gjatë këtij rrugëtimi kam bërë shoqëri me të cilët kemi krijuar kujtime të mahnitëshme, kemi ndihmuar dhe motivuar njëri-tjetrin, pa të cilët eksperiencia e kolegjit nuk do të ishte e njejtë.

Do të dëshiroja të shprehja mirënjohjen time të thellë dhe të sinqertë për Ph.D cand. Elmi Kelmendi i cili më ka mbikqyrur gjatë këtij rrugëtimi. Ndhem e nderuar dhe e privilegjuar që kam punuar dhe studiuar nën drejtimin e tij.

PËRMBAJTJA :

LISTA E FIGURAVE.....	IV
LISTA E TABELAVE.....	IV
FJALORI I TERMAVE	V
1. HYRJE	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	3
2.1. Historiku, kuptimi dhe definicionet mbi kriminalitetin e organizuar.....	3
2.2. Metodot dhe teorit mbi kriminalitetin e organizuar	6
2.3. Grupet kriminale dhe disa nga organizatat më të njohura kriminale	9
2.4. Format e kriminalitetit të organizuar	14
2.5. Kontrabanda me narkotikë	15
2.6. Kriminaliteti kompjuterik.....	19
2.7. Luftimi dhe parandalimi i kriminalitetit të organizuar	25
2.8. Mekanizmat ligjor dhe insitucional për trajtimin e kriminalitetit të organizuar	30
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT.....	36
4. METODOLOGJIA	37
5. PREZENTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE.....	38
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	39
7. REFERENCAT	40

LISTA E FIGURAVE

Grafiku 1.1. Përqindja e rasteve të neutralizimit të grupeve kriminale nga Policia e Kosovës.

Grafiku 1.2. Rastet e identifikuara nga Policia e Kosovës të kontrabandimi me narkotikë dhe të paraqitura në Raportet Vjetore të Policisë së Kosovës.

LISTA E TABELAVE

Tabela.1.1. Rastet me narkotikë gjatë periudhës kohore 2016-2018 të marrura nga Policia e Kosovës

Tabela 1.2. Konfiskimi i narkotikëve nga Policika e Kosovës 2016-2018.

Tabela 1.3. Rastet dhe asistimet në krimin kibernetik të paraqitura nga Policia e Kosovës.

Tabela 1.4. Konfiskimi dhe sekuestrimi i pasurive të luajshme.

Tabela 1.5. Konfiskimi dhe sekuestrimi i pasurive të palujatshme

Tabela 1.6. Administrimi i pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara gjatë viteve në total.

FJALORI I TERMAVE

BE – Bashkimi European

DEA – Drug Enforcement Agency (Agjencia e Zbatimit të Drogës)

SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

INTERPOL – Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale

EUROPOL - Agjencia e Bashkimit Evropian për bashkëpunimin e zbatimit të ligjit

KPP – Kodi i Procedurës Penale

KPRK – Kodi Penal i Republikës së Kosovës

FBI – Byroja Federale e Hetimeve

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

PK – Policia e Kosovës

1. HYRJE

Krimi si fenomen shoqëror dhe individual dhe shkaqet e tij, kanë qenë gjithmonë të pranishëm që nga paraqitja e shoqërisë njerëzore. Është një dukuri mjaft e ndërlikuar, prandaj është edhe kategori teorike, sepse në vete integron një numër të madh komponentesh të ndryshëm. Si formë, posaqërisht e rrëzikshme e manifestimit të krimit trajtohet kriminaliteti i organizuar. Problematika e krimit të organizuar, me karakteristikat dhe specifikat e saj, si problem shkencor dhe praktik i cili dëmton rëndë ekonominë dhe shoqërinë në përgjithësi, ka filluar të trajtohet më vonë. Varësisht nga cili aspekt interpretohet kriminaliteti i organizuar duke përfshirë aspektin juridik, ekonomik, sociologjik, psikologjik, socialo – psikologjik, politik, kulturor dhe aspekte të tjera, vërtetë ka ndikim të theksuar në jetën shoqërore dhe shkakton pasoja të mëdha me reaksione zinxhimore. Në bazë të këtyre aspekteve kriminaliteti duhet të analizohet nga aspekti i tërësisë së shoqërisë dhe se trajtimi ligjor i kriminalitetit paraqet rëndësi të madhe për parandalimin e tij. Ndër të tjera, konsiderohet si preokupim i madh i njerëzimit, sepse për shkak të natyrës së vet shkatërruese, ky fenomen gjithmonë ka zgjuar frikë, pasiguri dhe tmerr për shoqërinë në përgjithësi.

Për shkaqet dhe karakterin e kriminalitetit janë dhënë mendime të ndryshme. Lidhur me këtë çështje kriminaliteti apo sjellja kriminale shpesh herë janë shpjeguar si veprim i kryer nga ndikimi i forcave të mbi natyshme, mbi njerëzore dhe si rezultat i ndikimeve tjera të padukshme irracionale. Komplexiteti i krimit të organizuar qëndron në faktin se vazhdimisht shfaqen forma të reja të aktiviteteve kriminale, por edhe karakteristikat apo specifika të caktuara të këtyre aktiviteteve. Me të drejtë mund të thuhet se shkaqet dhe format e kriminalitetit janë të llojlojshme, ato ndryshojnë, avancohen dhe nuk e kanë të njëjtën rëndësi në procesin e zhvillimeve të ndryshme politiko – ekonomike. Së këndejmi, është e kuptueshme që në raste të tilla vështirësohet edhe më shumë puna e organeve hetuese në parandalimin, hetimin apo zbulimin e veprave penale si dhe të kryerësve të këtyre veprave penale që kryhen si pjesë e krimit të organizuar.

Gjatë punimit do të trajtohen termet dhe nocionet kriminalitetin të organizuar dhe krimin e organizuar. Krimi i organizuar është një veprimtari në vete që klasifikohet si formë e manifestimit të krimit të organizuar dhe ka të bëjë me krimin e organizuar që kryhet në një vend dhe nuk kryhet në vende të tjera, apo nuk është i shtrirë me grupe e veprimtari kriminale që ushtrojnë aktivitetin në vende të ndryshme. Përveq këtyre termeve, ekzistojnë edhe terme të tjera në lidhje me krimin e organizuar siç janë: “krim i organizuar nacional apo kombëtar”,

“krimi i organizuar ndërkuftar”, “krimi i organizuar tranzicional, “ krimi i organizuar ndërkombëtar”.

Në literaturën kriminologjike, “theksohet se vëllimi, forma e krimeve dhe sjelljeve kriminale, kanë qenë të lidhura ngushtë me zhvillimin dhe transformimin e shoqërive dhe sistemeve të caktuara shoqërore – ekonomike”. Krimi i organizuar konsiderohet një ndër format më të rrezikshme të kriminalitetit në shoqëri, shkalla e lartë e papunësisë dhe varfëria, gjithashtu kontribuojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti. Krimi i organizuar është një lloj i aktivitetit të paligjshëm të cilin e realizon një strukturë organizative trupore e ngjashme me shoqatat apo shoqëritë tona të zakonshme legale dhe ilegale dhe të cilat si synim themelor e kanë arritjen e përfitimit sa më të madh material, para dhe pasuri tjetër të paluajetshme dhe shfaqet më shumë në vendet ku këto organizata kriminale kanë pasur mundësi që veprimtarinë kriminale ta realizojnë në mungesë të ligjeve kufizuese dhe normave përcaktuese për parandalimin e tij.

Objektiva e këtij punimi janë:

- 1) Analiza dhe trajtimi i kriminalitetit të organizuar në bazë të legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtarë.
- 2) Identifikimi i veprimtarive kriminale të organizuara më të përhapura.
- 3) Prezentimi i statistikave nga institucione te ndryshme të drejtësis për kontrabandën me narkotikë dhe kriminalitetin kompjuterik.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1. Historiku, kuptimi dhe definicionet mbi kriminalitetin e organizuar

2.1.1. Historiku i kriminalitetit të organizuar

Historia e kriminalitetit të organizuar daton prej shumë dekadash. Zanafillen e kriminalitetit të organizuar e hasim qysh në shekullin XIX. Fillimisht, shtrirjen e tij e hasim në Itali dhe Amerikë e duke vazhduar edhe në vende të tjera. Kjo shtrirje e shpejtë edhe në vende të ndryshme bëri që kriminaliteti i organizuar të shëndrrohet në një fenomen në vete. Pra, kriminalitetin e organizuar e hasim kudo, madje është prezent edhe në Ballkan si rrjedhojë e kësaj edhe në Kosovë (*Poda, 1998*).

Termi “krim i organizuar”, është përdorur për herë të parë në vitin 1896, në Raportin e Shoqatës për Parandalimin e Krimit në New York. Në këtë raport, ky term përdorej për veprimet e prostitucionit dhe të bixhozit, të mbrojtura nga zyrtarë publik. Sipas këtij raporti, si krim i organizuar konsideroheshin bizneset ilegale në të cilat përfshiheshin politikanë, oficerë policie, juristë dhe hajna profesionist, kur krimi i tyre ishte i organizuar. Gjatë viteve 1920 dhe 1930, me qëllim të parandalimit të tregtisë ilegale në Amerikën e Veriut shënohen edhe përpjekjet e para për të përfshirë me nocionin e krimit të organizuar dhe kërkimet e vazhdueshme që u bëheshin pronarëve dhe biznesmenëve për falsifikimin e dokumentave, trafikimin e drogave apo edhe alkoolit (*Gashi, 2014*). Autori Ragip Halili, konstaton se kriminaliteti i organizuar krijon aftësi të përshtatjes së shpejtë në kushtet dhe rrethanat e reja, duke gjetur hapësirë për realizimin e fitimeve të mëdha (*Halili, 2016*).

2.1.2. Kuptimi i kriminalitetit të organizuar

Për kriminalitetin e organizuar hasim përkufizime të ndryshme. Mirëpo, rëndësia e konceptit të krimit të organizuar ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme me kalimin e kohës. Krimi i organizuar është një dukuri negative e rrezikshme e cila ka depërtuar në çdo segment të shoqërisë njerëzore. Gjatë historisë preokupimi, interesimi dhe reagimi i shoqërisë ndaj veprimeve kriminale ka qenë i ndryshëm, në përputhje me kushtet sociale janë paraqitur mjetet dhe masat për të luftuar veprimet e dëmshme dhe të rrezikshme për shoqërinë. Kjo formë e kriminalitetit manifeston disa veçori dalluese nga format e tjera. Sipas autorëve M.D. Lyman dhe G.W.Potter, kategorit të sjelljeve të krimit të organizuar janë: furnizimi me shërbime të paligjshme, furnizimi i paligjshëm i mallrave, konspiracioni, depërtimi në afarizëm legjitim, detyrimi dhe korrupsioni (*Gashi, 2014*).

Pas vitit 1990, krimi i organizuar është bërë një politikë e pranuar dhe koncept shkencor i pranuar praktikisht në gjithë botën. Andaj, kriminaliteti tenton që para se gjithash të dëpertoj në territoret e shteteve me demokraci të re, por edhe në shtetet e pazhvilluara, sepse këto shtete krijojnë mundsinë më të madhe për përhapjen e veprimeve të shumta kriminale (*Vula, 2013*).

Sipas autorit, Vesel Latifi, “kriminaliteti i organizuar është dukuri që kriminelët profesionistë, gjithnjë e më tepër po organizohen në grupe, banda dhe forma të ndryshme të bashkimit, të cilat ndërveti bashkëpunojnë në procesin e kryerjes së veprave të ndryshme kriminale”. (*Latifi, 2011*). Këto grupe apo banda kriminale kanë për qëllim nxjerrjen e fitimeve të mëdha (*Vula, 2013*) dhe fitimi i pasurisë në forma apo mënyra të kundërligjshme. Ndërmarrja e veprimeve kriminale nga ana e këtyre organizatave, përkatësisht antarëve të tyre, bëhet me plane dhe në bazë të ndarjes së detyrave të antarëve të grupit apo organizatës. Zakonisht, veprimet dhe aktivitetet ilegale nga ana e grupeve apo organizatave kriminale ndërmerren me anë të kërenimeve, shantazheve të ndryshme, korrupsionit, kontrabandës apo forma të tjera të kriminalitetit të organizuar.

Krimi i organizuar është një dukuri më e rrezikëshmeri shoqërore për gjithë shoqërinë, sepse nëpërmjet krimit të organizuar kërcënohet rendi publik, shoqëria dhe normaliteti social, pavarësia, integriteti dhe mbi të gjitha siguria kombëtare dhe ndërkombëtare. Kriminaliteti i organizuar konsiderohet si formë që manifestohet ngjashëm sikurse dukurit tjera kriminale, megjithatë ekzistojnë disa veçori dalluese në të cilat përfshihen ato grupe apo organizata kriminale.

2.1.3. Definicionet mbi kriminalitetin

Me përkufizimin e krimit të organizuar dhe të grupeve kriminale të organizuara janë marrë autorë të shumët, enciklopedi dhe fjalorë të ndryshëm si dhe disa organizata të karakterit ndërkombëtar dhe rajonal. Megjithatë, përkundër dallimeve të caktuara të cilat ekzistojnë në lidhje me përkufizimin e kriminalitetit të organizuar, hasim edhe në përafërime të qëndrimeve që kanë të bëjnë me nocionin e kriminalitetit të organizuar dhe karakteristikat e tjera themelore (*Gashi, 2014*). Kjo ndodh për shkak se krimi i organizuar në vendet e ndryshme të botës nuk manifestohet në mënyrë të njëjtë. Në Evropë, përpjekjet e para në lidhje me përkufizimin e kriminalitetit janë shënuar gjatë viteve të 80-ta, duke përfshirë edhe përkufizimin në aspektin ndërkombëtar (*Gashi, 2014*).

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Krimit të Organizuar, e nënshkruar në dhjetor të vitit 2000 është dokumenti i parë i cili ka definuar kriminalitetin e organizuar në nivelin global. Sipas kësaj konvente krimi i organizuar përkufizohet si: “një grup i strukturuar prej tre ose më shumë personash, që veprojnë në bashkëpunim, me qëllim që të sigurojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një përfitim financiar ose një përfitim tjetër material (*Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit , 2012-2017*)

Organizata e Kombeve të Bashkuara krimin organizuar e definojnë si:

“Veprimtari të fshehta të bëra nga grupe të organizuara prej më shumë se tre apo më shumë personash, për një kohë të gjatë me synimin e kryerjes së krimeve të rënda nëpërmjet veprimit të përbashkët dhe duke përdorur frikësimin, dhunën, korrupsionin ose mjete të tjera për të siguruar në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë për përfitim financiar ose të një lloji tjetër material” (*Përmbledhje e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ligjore Ndërkombëtare, 2016*).

Sipas INTERPOL kriminaliteti i organizuar përmbanë:

“Grupet që kanë një strukturë të përbashkët dhe të përbërë, objektivi parësor i të cilit është të sigurojë të ardhura nëpërmjet veprimtarive të fshehta, shpesh me anë të frikës dhe korrupsionit” (<https://www.interpol.int/en/Crimes/Organized-crime>, 1923).

Bazuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Krimit të Organizuar, Bashkimi Europian në vitin 1998, ka bërë përkufizimin e krimit të organizuar. Megjithatë, përpjekjet e BE-së për definimin e kriminaliteti kanë qenë të mëhershme, duke ratifikuar një dokument që bazohet në një listë prej 11 (njëmbëdhjetë) karakteristikave të krimit të organizuar (*Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit , 2012-2017*).

Sipas përkufizimit zytarë të BE-së si një nga dokumentet që ka fuqin e të drejtës ndërkombëtare me kriminalitet të organizuar kuptohet:

“Një shoqatë të strukturuar, të krijuar për një periudhë kohore, pjesëmarrjen e një ose më shumë personave, që operojnë në mënyrë të bashkërenduar, me qëllim kryerjen e veprave penale të cilat ndeshkohen me heqje lirie, ose urdhër izolimi, për të paktën katër vjet, ose edhe me një dënim akoma më të rëndë, kur këto vepra përbëjnë qëllim në vetvete, ose mjet për arritjen e përfitimeve materiale, ose sipas rastit, për të influencuar në mënyrë të padrejtë,

autoritetet publike operative” (*Përmbledhje e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ligjore Ndërkombëtare, 2016*).

Nga ky definicion nënkuptohet se krimi nuk njihet kufijë, shfaqet në çdo shtet të zhvilluar apo të pazhvilluar dhe jo vetëm. Përveç që nuk njihet kufinjë, nuk njihet kombë, atdhe, racë, gjini.

Në bazë të specialistëve të DEA-s kriminaliteti i organizuar konsiderohet veprimtari ilegale me të cilën merren grupet kriminale, veprimtari primare e të cilave hynë në shkeljen e ligjeve penale, gjatë një periudhe me qëllim profiti (*Vula, 2013*).

2.2. Metodatat dhe teorit mbi kriminalitetin e organizuar

2.2.1. Metodatat mbi kriminalitetin e organizuar

Fjala metodë rrjedh nga fjala greke *methodos* (*Gashi, 2014*) dhe nënkupton rrugën apo mënyrën për të arritur deri tek e vërteta. Sikurse në çdo shkencë tjetër, edhe për krimin e organizuar aplikohen metoda dhe teknika të shumta hulumtuese. Mirëpo, metodatat më të shpeshta që zbatohen për hulumtimin e kriminalitetit të organizuar janë:

- 1) **Metoda e studimit të rasteve individuale-** në vendet perendimore kjo metodë emërtohet si metodë e rastit dhe kryesisht i qaset kryesit të krimit, vetive dhe cilësive individuale të tij. Pra, studion sjelljet e delikuentit që nga koha e fëmijërisë e deri në momentin e kryerjes së krimit. Gjithashtu, në bazë të kësaj metode në mënyrë të detajuar studiohet dhe analizohet zhvillimi i delikuentit duke përdorur fakte dhe të dhëna sociologjike, psikologjike, psikiatrike dhe fakte tjera relevante. Konsiderohet një nga metodatat më të shtrenjëta, pasi që kërkon një qasje dhe tretman interdisiplinar, duke përfshirë ekspert të disiplinave të ndryshme (*Halili, 2016*).
- 2) **Metoda klinike-** përmes kësaj metode studiohet dhe analizohet sjellja kriminale sikurse në klinika mjekësore ku trajtohen sëmundjet e ndryshme, kjo nënkupton themelimin e shumë qendrave dhe institucioneve të posaçme për trajtimin e kësaj metode (*Gashi, 2014*). Nëse marrim parasysh mënyrën e aplikimit të kësaj metode dhe studimin e krimit të organizuar si dukuri individuale, vërejm se është e ngjajshme me metodën e studimit të rasteve individuale.
- 3) **Metoda e vrojtimit-** apo ndryshe metoda e observimit bën të mundur që të arrihen shumë të dhëna që kanë të bëjnë me kryesin e veprimeve kriminale. Aplikimi i metodës së vrojtimit bëhet në mënyrë direkte dhe indirekte dhe me pjesëmarrje të studiuesit dhe pa pjesëmarrje. Vjortimi direkt i bën të mundur hulumtuesit që në

mënyrë të drejtëpërdrejt të mbledhë të dhëna dhe shënime lidhur me qëndrimet, motivet, shprehjet, temperamentin, karakterin dhe shumë cilësi të tjera të delikuentit, ndërsa vrojtimi indirekt ka të bëjë me analizën e të dhënave dhe shënimeve që kanë të bëjnë me format e krimit të organizuar dhe kryesit e tyre (Gashi, 2014).

4) **Metoda e anketës dhe intervistës**- janë metoda të njohura të mbledhjes së fakteve të cilat aplikohen në të gjitha shkencat shoqërore. Anketa mund të bëhet me shkrim dhe me gojë dhe gjatë aplikimit të kësaj metode kërkohen të plotësohen disa parakushte duke përfshirë qëllimin e anketës, duhet të cakohen personat me të cilët do të bëhet anketa, pyetjet duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme dhe shumë faktorë të tjerë të cilët ndikojnë në realizimin e suksesshëm të anketës. Zakonisht, metoda e anketës realizohet me shkrim dhe preferohet të jetë anonim. Intervista në të shumtën e rasteve bëhet me gojë dhe ka ngjajshmëri me anketën. Mirëpo, përparësi e intervistes është se hulumtuesi përmes saj ka mundësi që të ndikoj në sqarimin e pyetjeve dhe ta orientoj më lehtë intervistuesin në përgjigje (Halili, 2016).

5) **Metoda statistikore**- konsiderohet metodë e përshtatëshme për mbledhjen, përcjelljen dhe pasqyrimin e të dhënave lidhur me vëllimin, dinamikën, stukturën dhe ndryshimet kohore, sezonale dhe karakteristikat e tjera të dukurisë së kriminalitetit (Halili, 2016). Dy teknikat më të njohura statistikore janë: metoda e ligjit të numrave të mëdhenj, metoda e modelit apo mostrës.

1) **Metoda e ligjit të numrave të mëdhenj**- sipas kësaj metode, në hulumtimin e krimit të organizuar duhet të përfshihen dhe analizohen më shumë raste sepse format e krimit të organizuar ndryshojnë në mes vete dhe kur hulumtohen raste masovike rezultatet janë më të qëndrueshme dhe besnike (Gashi, 2014). Pra, sa më shumë raste që përfshihen në studim aq më objektive janë edhe konkluzionet dhe përfundimet e analizës së krimit.

2) **Metoda e modelit apo mostrës**- nënkupton studimin e disa rasteve të krimit të organizuar të cilat e përfaqësojnë atë, e jo tërë dukurin në fjalë (Gashi, 2014).

Përveç këtyre egzistojnë edhe disa metoda të tjera të studimit të kriminalitetit të organizuar të cilat janë: 1) Metoda e korrelacionit, mesatarës dhe përqindjes, 2) Metoda e eksperimentit, krahasimit dhe matjes.

2.2.2. Teorit mbi kriminalitetin e organizuar

Në mënyrë që të shpjegohen shkaqet dhe natyra komplekse e kriminalitetit të organizuar janë paraqitur edhe teorit mbi kriminalitetin e organizuar me qëllim të luftimit dhe parandalimit të tij (Vula, 2013). Andaj, shumica e teorive dhe shkollave të cilat kanë të bëjnë me kriminalitetin në përgjithësi, vlejn edhe për krimin e organizuar (Gashi, 2014). Teorit më të njohura të cilat përmenden nga autorë të ndryshëm dhe trajtojnë karakterin dhe shkaqet e paraqitjes së kriminalitetit janë:

- 1) **Teoria e konspiracionit të huaj**- si teoria më bashkëkohore, krimin e organizuar e identifikon me shprehjen “mafia” dhe është paraqitur për herë të parë në Itali në vitin 1860 dhe përbëhet prej 25 familjeve kriminale, kryesisht të dominuara nga italianët (Vula, 2013). Sipas kësaj teorie përhapja e kimit të organizuar në shoqërinë amerikane është si pasojë e ndikimit nga shtetet dhe shtetasit e huaj. Kjo teori bënë përpjekje që t’i fajsojë të huajt dhe ndikimet e shteteve të huaja për paraqitjen dhe përhapjen e kimit të organizuar në shoqërin amerikane (Gashi, 2014).
- 2) **Teoria e papërshtatshmërisë**- sipas kësaj teorie, kriminaliteti dhe krimi i organizuar shpjegohen si rezultat i mosaftësisë dhe pamundësisë së përshtatjes apo adaptimit të delikuentit në rrethanat e caktuara shoqërore. Sipas Frojdit, njeriu bëhet kriminal nëse nuk arrin t’i realizoj kërkesat dhe dëshirat e veta dhe nëse këto dëshira nuk koordinon me normat e rrethit dhe të ambientit të caktuar shoqëror. Andaj, kjo teori bënë përpjekje që veprimet kriminale dhe krimin e organizuar ta shpjegoj duke u mbështetur në elementet psikike të individit (Halili, 2016).
- 3) **Teoria e grupit**– është teori e cila bënë përpjekje që sjelljet kriminale dhe krimin e organizuar t’i shpjegoj si rezultat i ndarjes së shoqëris në grupe të ndryshme (Vula, 2013). Këto grupe janë të ndryshme duke përfshirë grupe etnike, religjioze, kulturore, politike, raciale. Sjelljet dhe veprimet e grupeve të caktuara cilësohen si të rrëzikshme nga një grup tjetër. Andaj, këtu qëndron arsyeja e paraqitjes së sjelljeve kriminale dhe kimit të organizuar për shkak të kundërthënive në mes të grupeve të ndryshme në shoqëri (Gashi, 2014).
- 4) **Teoria e dezorganizimit shoqëror**- mundohet që t’i shpjegoj sjelljet kriminale duke përfshirë edhe krimin e organizuar si pasojë e një dezorganizimi shoqëror (Vula, 2013). Sipas autorit Rexhep Gashi: ”si gjendje e dezorganizuar nënkuptojmë gjendjen në shoqëri në të cilën nuk kemi funksionim normal të institucioneve dhe segmenteve

tjera shoqërore, andaj kjo gjendje krijon terren të përshtatshëm për paraqitjen e krimit të organizuar”.

Teorit e tjera të cilat e shpjegojnë apo ndikojnë në parandalimin e kriminalitetit të organizuar janë: 1) Teoria e konflikteve dhe dallimeve kulturore, 2) Teoria e anomisë, 3) Teoria e interaksionit dhe etiketimit (*Vula, 2013*).

Këto teori, kriminalitetin e konsiderojnë si dukuri normale shoqërore sepse ky është atribut i përhershëm në çdo shoqëri. Kjo nënkupton se nuk ka shoqëri pa kriminalitet dhe është dukuri e pashmangshme. Krimi i organizuar konsiderohet se paraqitet si pasojë e reagimit, aksionit të organeve të ndjekjes, organeve të kontrollit të pushtetit dhe të gjykatave të cilët disa individ i shpallin si kriminel (*Gashi, 2014*).

2.3. Grupet kriminale dhe disa nga organizatat më të njohura kriminale


2.3.1. Nocioni i grupit kriminal të organizuar

Siç e kemi cekur edhe më lartë, trajtimin e kuptimit të grupit kriminal të organizuar e hasim në përkufizime të ndryshme dhe të llojllojshme nga shumë autorë dhe legjislacione tjera përkatëse. Dr. Vasilika Hysi, konstaton “ndonëse nuk ekziston një përkufizim uniform i krimit të organizuar, grupet kriminale në Evropë dhe më gjerë po bëjnë përpjekje për të bashkërenduar aktivitetet dhe ndarë zonat e veprimit ndërmjet tyre” (*Latifi, 2014*). Mirëpo, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një kontribut të veçant për kufizimin e grupeve kriminale kanë dhënë disa komisione, agjenci dhe organizma të tjerë.

Komisioni Amerikan për Krimin e Organizuar grupin kriminal të organizuar e përkufizon si një grup të involvuar në kryerjen e krimit të organizuar, grup i cili veçohet me antarë të strukturuar mirë, i përbërë nga personat të cilët kryejn krime, si dhe ushtrojnë dhunë dhe korrupsion me qëllim që të fitojnë apo mbajnë fuqinë apo ndonjë profit tjetër (*Gashi, 2014*). Gjatë vitit 2002 është mbajtur Konferenca e Londrës kushtuar krimit të organizuar në Evropën Juglindore dhe si prioritet kryesor është theksuar zhvillimi i aftësisë së BE-së që ti kundërvihet kërcënimit nga krimi i organizuar dhe ndërprerja e aktiviteteve të grupeve kriminale. Në lidhje me këtë çështje është miratuar Deklarata e parimeve themelore të drejtësisë në lidhje me viktimat e kriminalitetit dhe të viktimave të shpërdorimit të pushtetit dhe sipas saj “kur një shtet nacional është i rrezikuar nga krimet, shtetasit e atij vendi kanë të drejtë të kërkojnë nga Kombet e Bashkuara intervenim dhe ndihmë në luftimin dhe mbrojtjen nga krimi” (*Latifi, 2014*).

Gjithashtu, Kombet e Bashkuara grupet e organizuara kriminale i definojnë si bashkim të strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, i tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të rënda penale për përfitime të drejtëpërdrejt ose tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore (Gashi, 2014). Grupet kriminale në përgjithësi janë grupe të cilat nuk kanë qëllime politike, janë hierarkike, kanë anëtarë të kufizuar, kanë subkulturë unike, janë të vetëpërhershme, manifestojnë (Gashi, 2014). Një raport publikuar nga Nisma Globale Kundër Krimin të Organizuar Transnacional e përshkruan kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën, si një mjedis aktiv kriminal ku aktivitetet kryesore të grupeve të kriminit të organizuar përfshijnë trafikimin e drogës, ndërsa Peja në Kosovën perëndimore është në kryqëzimin e një sërë rrugësh kryesore trafikimi. Mirëpo, ndër vite është bërë edhe neutralizimi i grupeve kriminale. Në bazë të raporteve të Policisë së Kosovës ekzistojnë këto të dhëna:

Grafiku 1.1. Përqindja e rasteve të neutralizimit të grupeve kriminale nga Policia e Kosovës.



2.3.2. Disa nga organizatat më të njohura kriminale

Të flasësh për krimin e organizuar, në radhë të parë duhet të flasësh për mafian si organizatë kriminale. Kuptimi klasik i mafias së organizuar mbi baza familjare, me organizime të vogla është duke ndryshuar çdo ditë. Mafia apo organizata kriminale është një veprimtari kriminale e cila përbën një kërcënim për shtetin, administrojnë aktivitetin kriminal dhe krijojnë një

pushtet të ngritur në sistem dhe synojnë ta konkurojnë shtetin, andaj, këto organizata kriminale krijojnë pasiguri në vend dhe ndikon në humbjen e paqës së popullit.

Organizatave kriminale për herë të parë janë paraqitur në vitet e 70-ta në SHBA dhe sipas kriminologëve është vërtetuar se ekziston alenanca nacionale e organizatave kriminale të tipit mafioz apo familja dhe antarët e të cilëve kanë lindur në Itali apo janë me origjinë nga Italia. Sipas Umberto Santio: “mafia sicilae nuk e ka pushtuar botën, por bota e sotme me kontradiktat e saj të shumta të natyrës ekonomike, sociale dhe politike ka prodhuar gjithë e më shumë grupe dhe organizata të tipit mafia” (Vula, 2013).

Ndërsa, Kodi Penal Italian përkufizimin e organizatës së tipit mafioz e jep në këtë formë: “ekzistimin e grupit prej tre apo më shumë personave; antarët e saj përdorin forcën për realizimin e detyrimit ata janë të detyruar që ti përmbahen nënshtrimit dhe kodit të heshtjes përkitazi me veprimet e grupit; veprimet e tyre janë të drejtuara në realizimin e kontrollit ndaj ecurive ekonomike, tregtisë dhe shërbimeve publike, qëllimi final i të cilave është që vetës apo të tjerëve t’i siguroj të hyra ilegale” (Gashi, 2014).

Në botë ekzistojnë disa organizata të njohura kriminale të cilat dallojnë në mes vete për nga mënyra e organizimit dhe veprimit. Këto organizata kriminale janë:

- 1) **Cosa Nostra Amerikane**- është organizatë kriminale e paraqitur për herë të parë në Itali dhe aktivitetin e vet kriminal e ka vazhduar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kanë një strukturë organizative mjaftë të përsosur. Kjo organizatë kriminale është e organizuar në formë të familjeve të cilat kanë sindikatat e tyre dhe është e regjistruar si sindikat legale, por aktiviteti i saj kryesisht është aktivitet me veprimet dhe transkacione të llojllojshme kriminale (Halili, 2016). Cosa Nostra veprimtarin e vet kriminale e realizon përmes shantazhit, plaçkitjes të armatosur, bixhozit, organizimit me trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandë me drogë, prostitucion ilegal, vrasjet e ndryshme. Këto veprimtari kriminale, zakonisht realizoheshin nga njëri ndër shefat më të njohur të mafias amerikane Al Capone. Gjatë karrieres së tij kriminale Al Capone konsiderohej si mbret i së keqes dhe krimit. Janë të njohura vrasjet e shumta dhe masakrat mizore që janë kryer nga ana tij, në mesin e tyre edhe Masakra në ditën e Shën Valentinit në vitin 1929. Qëllimi kryesor i organizës kriminale të Al Capone ishte që përmes masakrave dhe vrasjeve të futnin tmerrin ndaj rivalëve të vet, se kushdo që tenton t’i bënte konkurrencë do ta priste një fund fatal (Gashi, 2014).

- 2) **Mafia Siciliane-** konsiderohet një nga organizatat kriminale më të vjetëra dhe me një traditë të gjatë të zhvillimit. Për herë të parë është paraqitur në Sicili të Italisë dhe është krijuar me qëllim të rezistimit ndaj pushtimit francez. Sipas autorit Anxhelo Umilta: disa nga rregullat dhe normat e sjelljes së antarëve të mafias janë: mbajtja e heshtjës për krimet e kryera, obligimi për t'i vajtur në ndihmë të gjithë të akuzuarve ose kriminelëve të lirë, por që janë fshehur dhe ndërmarrja e masave për t'i shpëtuar ata, goditje pa mëshirë e cilitdo që është përcaktuar në hakmarrjen e shoqërisë, realizimin e hakmarrjes dhe mos falja kurrë e atyre ndaj tradhëtarëve, sfidat për rregullat e policisë, transportimi i armëve të ndaluara (*Gashi, 2014*).
- 3) **Ndregeta-** është pjesë e organizatave kriminale të cilat veprojnë në Itali. Kjo organizatë përveç që ka sindikaten e vet, përbëhet prej 150 kanale dhe 5500 antarë (*Halili, 2016*) dhe realizon të ardhura të mëdha përmes veprimtarive kriminale të cilat janë rrëmbimi i personave të fuqishëm, bisnismenëve dhe akteve tjera të reketizmit. Kohëve të fundit Ndregeta si organizatë kriminale po merret veçmas me kontrabandim të cigarve dhe droga dehëse (*Gashi, 2014*).
- 4) **Camorra-** organizatë tjetër kriminale e cila vepron në Napoli dhe zanafillën e saj e ka në Spanjë. Kjo organizatë kriminale ka një organizim të rripët e cila ka bërë rekrutimin e antarëve në burgje dhe qendra të tjera të korrektimit ku ata kanë filluar të aftësohen për grabitje profesionale dhe vrasje të porositura. Veprat kriminale të kryera nga kjo organizatë janë: trafiku drogave, reketizimi, prostitucioni, trafiku kalandestin i personave si dhe të gjitha llojet e grabitjeve (*Gashi, 2014*).
- 5) **Sacra Corona Unita-** është krijuar me bashkimin e disa grupeve të cilat u kanë përkatur organizatave Camorra dhe Ndregeta. Veprimtaria e kësaj organizate fillimisht shtrihej në fushën e industrisë së vajit të ullirit e më pas edhe në veprimtari tjera kriminale siç janë: mashtrimet, kontrabanda e armëve dhe trafiku i drogave, mirëpo më vonë janë specializuar në kryerjen e shumë veprave kriminale duke përfshirë: kontrabandën e cigarve, kontrabandën e njerzëve, kontrabandën e armëve (*Gashi, 2014*).
- 6) **Stidda-** apo siç njihet me emrin tjetër ylli është organizatë tjetër kriminale italiane e cila veprimtarin e vet e zhvillon në shumë provinca duke përfshirë provincat e Agrixhentos, Kaltanisetës, Enas, Raguzës si dhe në ishujt sicilian. Antarët e kësaj organizate kriminale janë të njohur për vendosjen e tatuazheve në formë ylli. Karakteristik interesante e kësaj organizate kriminale është se ka një aftësi të rallë për

të evoluar dhe ndryshuar rregullat, strukturën e brendshme dhe raporteve midis klaneve të ndryshme (Vula, 2013).

- 7) **Yakuza japoneze-** është një ndër organizatat më të njohura kriminale, me sindikatën mjaft të fortë dhe të organizuar dhe paraqet një ndër format më komplekse të aktivitetit kriminal në botën bashkëhore (Halili, 2016). Fillet e formimit të kësaj organizate i hasim qysh në shekullin XVII, ku si pasoj e përfundimit të luftrave në një pjesë të madhe të Japonisë dhe krijimit të paqes janë larguar nga një numer i ushtarëve profesional pjestarë të formacioneve të ndryshme të quajtur Samourai (Vula, 2013). Yakuza japoneze ka sindikatën e cila quhet “Sumiyoshi-Rengo”, ndërsa sindikata tjetër quhet “Inagawa-Kai” të cilat realizojnë qarkullim vjetor afro 2 miliard. Veprimtarit kriminale me të cilat merret kjo organizatë kriminale janë: organizimi e prostitucionit, kontabandën e armëve, me reketizëm, organizimin e bixhozit, larjen e parave e shumë vepra të tjera kriminale. Kjo organizatë kriminale mbanë lidhje me organizata të ndryshme kriminale, mirëpo ka një ngjajshmëri të madhe me atë të mafias sicilane (Gashi, 2014).
- 8) **Triada kineze-** gjithashtu është organizatë e njohur kriminale e cila aktivitetin kryesor e zhvillon në Hong-Kong, por veprimtarin e tyre e shtrijnë edhe në SHBA dhe disa vende tjera evropiane përmes shitblerjes së drogës, organizimin e bixhozit, organizimin e prostitucionit, rekretizëm dhe shantazhe të ndryshme, tregtia me armë dhe tregtia me femra (Halili, 2016). Në bazë të literaturave të ndryshme thuhet se ekzistojnë grupe të shumta të triadave kineze, vetëm në Hong-Kong llogaritet të jenë afro 70 grupe të tilla (Gashi, 2014).

Meqenëse, me krim të organizuar nënkuptohet krijimi i grupeve dhe bandave të ndryshme të organizuara që bashkëpunojnë në mënyrë të rregullt për kryerjen e veprave penale, këto janë disa nga organizatat kriminale më të njohura në shoqërit bashkëkohore. Në këto organizata kriminale mbretëron: nënshtrimi i plotë, frika, dhuna dhe tortura e vrazhdë ndaj antarëve të cilët gabojnë ose nuk dëgjojnë, me fjalë të tjera dominon “Ligji Heshtjes” dhe “Ligji i Hakmarrjes” sepse në rast të ndonjë lëshimi, gabimi, zbulimi apo thyerje e rregullave të ruajtjes së fshehtësis nga ana e antarëve të organizatave kriminale ndëshkohet ashpër (Halili, 2016).

2.4. Format e kriminalitetit të organizuar

Kriminalitetit i organizuar është një dukuri komplekse dhe heterogjene si për nga format, ashtu edhe për nga shkaqet e paraqitjes së tij. Format e manifestimit të kriminalitetit dhe sjelljeve kriminale ndahen sipas kritereve të cilat varen prej autorëve, drejtimeve apo shkollave të ndryshme kriminale. Sipas burimeve të litetratuese në Amerikë, format e manifestimit të kriminalitetit të organizuar janë: mashtrimet në sistemet monetare bankare dhe ekonomike, shoqatat e sigurimit, mbikëqyrja dhe udhëheqja e kazioneve ilegale, prostitucioni, tregtia me njerzë, reketit, kontrabanda me armë dhe narkotikë, kriminaliteti kompjuterik e forma të ngjashme të cilat ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit (*Vula, 2013*).

Si forma të reja konsiderohen sjelljet kriminale që kanë të bëjnë me disa dukuri dhe fenomene bashkëkohore të sjelljeve kriminale me narkomaninë, terrorizmin, kindapimin, krimet kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, pastrimi i parave, krimet kompjuterike, korrupsioni dhe krime të tjera të cilat trajtohen si dukuri antishoqërore me rrëzikëshmëri të veçant dhe pasoja të rënda (*Halili, 2016*). Dy nga format më të rënda të manifestimit të kriminalitetit të organizuar të cilat do të trajtohen gjatë këtij punimi janë : *1) Kontrabanda me narkotikë dhe 2) Kriminalitetit kompjuterik.*

2.4.1. Kontrabanda me narkotikë

Fillimisht, kontrabanda paraqet një dukuri aktuale negative e cila manifestohet në mënyra të ndryshme dhe të shumëfishta. Përmasat e përhapjes së kontrabandës së bashku me format e saj, e bëjnë kontrabandën si trajtën më të organizuar të kriminalitetit e cila paraqet një numër të madh të pasojave negative në shoqëri (*Latifi, 2011*). Fillimi dhe zhvillimi i kontrabandës janë të lidhura me dukurinë e paraqitjes së kufinjëve shtetëror, përmes të cilave janë krijuar pengesat për këmbimin e lirë të mallrave. Në periudhën para kapitalizmit, për kontrabandën mund të thuhet se ka pasur karakter strategjik dhe ushtarak, e më vonë ajo merr trajtë të theksuar komerciale duke u manifestuar si një biznes i gjerë i kundërligjshëm dhe në disa periudha të caktuara kohore ka vënë në pozitë mjaftë të vështirë shumë ekonomi nacionale (*Vula, 2013*).

Për kontrabandën egzistojnë definime të ndryshme, mirëpo shprehen edhe dilemat që kanë të bëjnë kryesisht me çështjen se a është kontrabandë çdo transport ilegal përtej kufirit apo vetëm ai transport i cili përmbush parakushtet e caktuara. Për më tepër, autori S. Fileta konstaton se kontrabanda është çdo lloj i transportit ilegal të mallit përtej kufirit dhe për nga

aspekti i përkufizimit të kontrabandës është shumë i gjerë dhe joadekuat për kushtet bashkëkohore, ndërsa për nga aspektin kriminologjik ka kuptim të plotë, sepse në përkufizimin e tij përmbledh të gjitha trajtat e transportit ilegal të mallrave me vlera të ndryshme (Vula, 2013).

Nga pikëpamja e termave ekonomike, kontrabanda është një lloj evazioni nëpërmjet hyrjes ose daljes së paligjshme të mallrave të tatueshëm nga territori kombëtar, që shpeshherë përdoren jo vetëm për të tregtuar një prodhim të paligjshëm, por edhe për shitjen e tyre, duke i'u shmangur pagimit të taksave. Ndërsa sipas amerikanëve, kontrabanda përbën një transport ilegal përmes shteteve apo kufijve kombëtarë të mallrave apo personave, përgjegjësi e ndaluar nga doganat dhe nga ligji. Një transportim i fshehtë i mallrave, duke shkelur ligjin dhe rregulloret. Për shembull, dikush mund të kontrabandojë drogë, cigare pa pullë, armë ose të tjerë mallra të ndaluara me ligj. Në mënyrë alternative, dikush mund të kontrabandojë mallra të ligjshme, duke i marrë ato në zona të ndaluara (burgjet) ose duke mos iu nënshtruar rregullave të aplikueshme, si në rastin e mospagimit të një takse (Dictionary, 2012).

Kontrabanda mund të definohet edhe si transport i mallit me një vlerë të lartë përtej kurifit, në mënyrë të organizuar në trajtë profesioni. Kështu, sipas autorit Ismet Elezi:” me kontrabandë nënkuptohet kalimi i mallrave dhe sendeve me vlerë dhe i objekteve tjera jashtë vendeve ku ka zyra doganore, ose kalimi i tyre nëpërmjet zyrave doganore duke i'u shmangur kontrollit doganor me anë të fshehjes së sendeve, kur kryhet më shumë se një herë (Elezi, 1995). Kjo sjellje kriminale manifestohet përmes formave të ndryshme duke përfshirë kontrabandën me mallra, kontrabandën me armë dhe municione, trafikimin e qenieve njerzore, kontrabanda me automjete, kontrabanda me vlera kulutore dhe të artit. Mirëpo, një ndër format kryesore të kontrabandës e cila do të trajtohet në vazhdimësi të punimit është kontrabanda me narkotikë.

2.5. Kontrabanda me narkotikë

Kontrabanda me narkotikë dhe substancat tjera psikotrope konsiderohen një ndër format më të rrezikëshme të paraqitjes së krimit të organizuar. Narkotikët janë substanca natyrore dhe sintetike të cilat, me konsumimin e tyre ndikojnë në sistemin qendror nervor të njeriut duke shkatërruar një gjendje të varësis së njeriut dhe konsumimin e vazhdueshëm të tyre, andaj këtë formë të krimit të organizuar e hasim në SHBA dhe në Evropë, përkatësisht në Evropën Lindore dhe Qendrore (Latifi, 2014). Në bazë të shumë komponenteve duke përfshirë mënyrën e transportit, bartjes, ndërlidhjes së regjioneve prodhuese me tregun ilegal të

narkotikëve, eliminimit të erërave me qëllim të bartjes më të lehtë përtej kufinjëve si dhe komponenteve të tjera, mund të konstatohet se kontrabanda me narkotikë nuk është një aktivitet spontan i individëve, por një veprimtari e organizuar kriminale (*Vula, 2013*).

Sipas autorit gjerman Werner Pietrzik:” kontrabanda me narkotik është si një ndër format e kriminalitetit të organizuar, çfarë sot ekziston në hapsirat evropiane, në pjesën më të madhe, gjendet në duart e bandave kriminale të organizuar në planin ndërkombtarë”. Nga kjo mund të konkludojm se kontrabanda me narkotikë ka një karakter të rrezikshmërisë shoqërore dhe dukshëm mund të thuhet se është një biznes jashtëzakonisht i zhvilluar dhe për nga aspekti i organizimit vështirë se mund të krahasohet me ndonjë veprimtari tjetër kriminale (*Vula, 2013*).

Ndër llojet e drogave dehëse dhe substancave narkotike më të njohura janë: opiumi, morfina, heroina, kokaina, marihuana, kanabisi e lloje të tjera, dhe prodhuesit kryesor konsiderohen Spanja dhe Holanda (*Gashi, 2014*). Kanalet e kontrabandimit të këtyre drogave përfshijnë një numër të madh pjesëmarrsisht, duke filluar nga financuesit, prodhuesit, transportuesit, ndërmjetësuesit e deri te shitësit e tyre. Pra, këto kanale përbëjnë një strukturë tejet heterogjene të njerzëve, ndërmjet të cilave ekziston një ndarje e përkryer e punëve (*Vula, 2013*). Duke theksuar se kanalet e kontrabandës, të cilat përfshijnë një numër të madh të pjesëmarrësve, janë të organizuar në mënyrë që pjesmarrësit me pak të njihen në mes veti. Shkalla e hierarkisë është e rregulluar në atë formë që policia nuk është në gjendje ta zbulojë organizatorin kryesor dhe financierët, por kryesisht zbulohen trafikantët dhe ndërmjetësuesit jo shumë të rëndësishëm (*Gashi, 2014*).

Karakteristikë e krimit të organizuar në fushën e kontrabandës së drogës është fakti se ato manifestohen në forma të ndryshme, të cilat i'u përshtaten ofertave dhe kërkesave në treg (*Latifi, 2014*). Kjo veprimtari kriminale ofron kushte tejet të volitshme për pasurimin e këtyre organizatave, andaj, përfitimet që arrijnë grupet kriminale përmes kontrabandës me narkotikë konsiderohet të jenë tepër të larta. Sipas të dhënave, vetëm në SHBA gjatë vitit 1984, fitimet nga kjo veprimtari kriminale kanë kaluar shifrën prej 40 miliardë dollarë, ndërsa në Kanada në vitin 1982, fitimet ishin rreth 10 miliardë (*Gashi, 2014*).

Duke u bazuar në raportin mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindore, vlersohet se 5% e popullatës apo 200 milionë njerzë të moshave 15-64 përdorin drogat e paligjshme të paktën një herë, ndërsa 2.7 % e kësaj popullate përdorin rregullisht drogat. Numri i atyre të cilët njihen si narkomanë apo përdorues të drogave arrin

deri në 25 milionë persona në të gjith botën. Ndërkohë, që numri më i madh i përdoruesve të drogave gjenden në vendet e zhvilluara e sidomos në Evropë e cila duket se përbën tregun më fitimprurës të drogës në botë, po të merret parasysh fuqia blerëse dhe numri i përdoruesve të drogave (<https://rm.coe.int/16806ef3d4>, 2006).

Kontrabandistët me narkotikë, janë të lidhur mirë ndërmjet vete, të organizuar, teknikisht të përgaditur dhe mundohen që në mënyra të ndryshme t'u ofrohen doganiereve, inspektorëve dhe të tjerëve që me dhurata dhe shpërblime të tjera, ti bëjnë për vete duke i korruptuar ata doganier dhe policë për të cilët mendojnë se do t'iu ndihmojnë në kryerjen e veprimtarive kontrabandiste. Megjithatë, natyra e kontrabandës me narkotik përbën delikt ndërkombëtar. Kjo nënkupton se pjesëmarrës në këtë veprimtari janë personat nga shtetet e ndryshme të cilët kanë një sistem të zhvilluar të lidhjeve dhe të komunikimit. Mirëpo, çdo shtet është i obliguar që të siguroj një nivel optimal të bashkëpunimit të organeve të veta, të cilat duhet të veprojnë për luftimin e kësaj dukurie negative në shoqërinë bashkëkohore (Vula, 2013).

Andaj, duke nisur nga pasojat e shumta të kësaj dukurie kriminale, janë bërë përpjekje të ndryshme në luftimin dhe parandalimin e kontrabandës së drogave dehëse. Ligji mbi prodhimin dhe qarkullimin e drogës në SHBA, bënë kufizimin e prodhimit, shitjes dhe importit të drogave dehëse (Gashi, 2014). Gjithashtu, Republika e Kosovës, është duke bërë përpjekje që të përmirësojë situatën aktuale përmes parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie me qëllim të progresit drejt rrugës së integriteteve euro-atlantike, njëkohësisht shpreh vullnetin për të bashkëpunuar me të gjitha shtetet dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtar për të minimizuar pasojat nga drogat (Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër narkotikëve dhe plani i veprimit , 2012-2017). Sipas Kodi Penal i Republikës së Kosovës në kapitullin XXIII parasheh “Veprat penale kundër narkotikëve” dhe janë të parapara këto vepra:

- 1) Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge
- 2) Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike
- 3) Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge; Intoksikimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope
- 4) Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge

- 5) Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit; Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope
- 6) Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull.

Në bazë të raporteve statistikore të marrura nga Policia e Kosovës për periudhën kohore 2016-2018 janë paraqitur këto raste të narkotikëve:

Tabela.1.1. Rastet me narkotikë gjatë periudhës kohore 2016-2018 të marrura nga Policia e Kosovës.

Vitet	Rastet	Të dyshuar	Trafikim	Posedim	Kultivim
2016	888	1166	198	799	85
2017	1368	1732	239	1095	33
2018	1866	2322	283	1574	18

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe kohore është bërë edhe konfiskimi i llojeve të ndryshme të drogave të cilat do të paraqiten në vazhdim:

Tabela 1.2. Konfiskimi i narkotikëve nga Policika e Kosovës 2016-2018.

Vitet	Heroinë (g)	Marihuana(g)	Kokainë (g)	Hashash (g)
2016	84.55 g	1146 kg 949.4 g	168.33 g	8 kg
2017	391.3 g	1908 kg 175.25g	711.65 g	/
2018	119 kg 026.39 kg	987281.66 g	1708.77 g	11.58 g

Policia e Kosovës si Agjencia për zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së, ka përgjegjësinë e plotë në luftimin kundër përdorimit, blerjes, posedimit, shitjes, shpërndarjes, importimit, eksportimit, përpunimit, kultivimit, dhe përgatitjes së substancave ose preparateve që janë të shpallura të rrezikshme si droga dhe së bashku me Doganën e Kosovës, janë institucionet e para të luftimit të aktiviteteve të paligjshme për arsye të rolit të tyre në ruajtjen e kufirit të Kosovës dhe parandalimit të lëvizjeve të tregtimit të paligjshëm, (*Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër narkotikëve dhe plani i veprimit , 2012-2017*), sepse kjo veprimtari kriminale realizohet përmes 1) Kufiri Kosovë - Shqipëri 2) Kufiri Kosovë – Maqedoni, 3) Kufiri Kosovë – Serbi.

Angazhimi i të gjitha institucioneve për të parandaluar dhe luftuar dukurinë e drogave me veprime sistematike dhe të koordinuara mirë me qëllim shkatërrimin e rrjeteve të shpërndarjes dhe tregtimit të drogave në të gjitha nivelet. Andaj, lufta dhe parandalimi i kontrabandës me narkotikë ka qenë pritoritet kryesor ndër vite dhe së bashku me MPB-në të Republikës së Kosovës, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për t'u anëtarësuar në organizatën evropiane të EUROPOL-it dhe organizatën e INTERPOL-it – anëtarësimi i cili do të ishte në interes jo vetëm të Kosovës, por edhe shteteve të tjera në adresimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë (*Raporti Vjetor i Policisë së Kosovës, 2016*).

Sipas raporteve vjetore të Policisë së Kosovës për periudhën kohore 2016-2019, në Republikën e Kosovës janë paraqitur raste të shumta të kontrabandës së narkotikëve.

Grafiku 1.2. Rastet e identifikuara nga Policia e Kosovës të kontrabandimi me narkotikë dhe të paraqitura në Raportet Vjetore të PK-së.



2.6. Kriminaliteti kompjuterik

Kriminaliteti kompjuterik është një ndër format e kriminalitetit të organizuar dhe një dukuri relativisht e re. Për kriminalitetin kompjuterik si formë e re e krimit të organizuar në botën bashkëkohore, deri tani nuk ka pasur ndonjë qëndrim të përbashkët lidhur me definicionin apo fillet e paraqitjes së kësaj veprimtarie kriminale (*Vula, 2013*). Fillet e paraqitjes së kriminalitetit kompjuterik, autorët tjerë i lidhin me vet zhvillimin gradual të kompjuterëve

elektronik digjital në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe aplikimin e gjerë të tyre në fushat e ndryshme të jetës, prej nga edhe filluan keqpërdorimet e para me ndihmën e kompjuterëve.

Shoqëria bashkëkohore sot ballafaqohet me të arriturat më të mëdha të zhvillimit tekniko-teknologjik, të cilën e përcjellë ekspansioni i shpejtë i teknologjisë informatike dhe automatizimi i proceseve të punës në të gjitha sferat e jetës shoqërore e ekonomike. Ky zhvillim në shoqërinë bashkëkohore ka sjellë një numër të madh lehtësimesh në njërën anë, ndërsa në anën tjetër keqpërdorimi i paramenduar i këtyre të arriturave teknologjike, ka krijuar edhe një numër problemesh dhe rreziqesh, si për individë dhe grupe, ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi (Vula, 2013).

Autori i parë i cili ka shkruar punim shkencor mbi kriminalitetin kompjuterik është Von zur Muhlen në vitin 1973 dhe sipas tij: “kriminaliteti kompjuterik përfshinë të gjitha sjelljet në të cilat kompjuteri është mjet dhe qëllim i veprimtarisë kriminale dhe format e kriminalitetit kompjuterik janë: manipulimi, spiunazhi, sabotimi, manipulimi me programe” (Latifi, 2014). Ndërsa, autorë të tjerë, duke përfshirë E.H. Sutherland në punimin e tij “White Dollar Crime” konstaton se fillet e paraqitjes së kriminalitetit i hasim tek paraqitja e kriminalitetit të jakës së bardhë në fillim të shekullit XX. Sipas Institutit të Standordit, statistikat e para mbi kriminalitetin kompjuterik janë paraqitur që nga vitin 1958 ku është shënuar rasti parë i keqpërdorimit të kompjuterik, ndërsa në vitin 1966 është shënuar rasti i parë që kompjuteri është shfrytëzuar si mjet për kryerjen e vjedhjes në një bankë në Minesota (Veton Vula, 2018). Ndërsa, në bazë Strategjisë së Sigurisë Kibernetike të Bashkimit Evropian: “kriminaliteti kibernetik i referohet përgjithësisht një spektri të gjerë veprimtarish kriminale të ndryshme, ku kompjuterët dhe sistemet informative angazhohen ose si vegël primare ose si shënjestër primare.

Krimi kibernetik përfshinë veprat penale tradicionale (p.sh. mashtrimi, falsifikimi dhe thyerja e identitetit), veprat në lidhje me përmbajtjen (p.sh. shpërndarja në internet e pornografisë së fëmijëve apo nxitja e urrejtjes racore), si dhe veprat që janë unike për kompjuterë dhe sisteme informative (p.sh. sulmet ndaj sistemeve informative, mohimi i shërbimit dhe maluer (malware) (Strategjia Shtetërore për sigurinë kibernetike dhe plani i veprimit , 2016-2019). Duke trajtuar mendimet e autorëve nga literatura të ndryshëm, lidhur me kuptimin dhe definicionin e kriminalitetit kompjuterik, konstatohet se kriminaliteti kompjuterik është një formë e veçantë e kriminalitetit, në të cilën kompjuteri paraqitet si mjet për kryerjen e veprimit ilegal apo si objekt studimi, i drejtuar nga personat të cilët posedojnë njohuri dhe

prirje të veçanta për sistemet kompjuterike me qëllim që vetes apo tjerëve t'u sjellin përfitime (Vula, 2013). Kodi Procedurës Penale, në nenin 147 ka paraparë veprimin hetimor “Analiza kompjuterike”. Pra, ky nen i nënshtrohet rregullave të ekspertizës dhe deklaratës së ekspertit mbështetur nga nenet 136-142 të KPP.

Përdorimi i kompjuterit si mjet për kryerjen e krimit, mund të bëhet për këto forma të krimit kompjuterik si: “keqpërdorimet financiare, krijimin dhe përhapjen e viruseve, vjedhjen e informatave nga sistemet e huaja kompjuterike (Veton Vula, 2018). Në ditët e sotme, organizatat kriminale më të mëdha shfrytëzojnë kompjuterët si mjet për planifikimin dhe kontrollimin e veprimeve të tyre kriminale, sepse transferi elektronik i fondeve i'u mundëson bartjen e shpejtë dhe të sigurt të shumave të mëdha të parave të krijuara nga punët tradicionale të sindikatave, e që pastaj transferohen nëpër llogari të bankave të ndryshme ndërkombëtare dhe në këtë mënyrë ndihmojnë në shpërlarjen e parave të ndyta (Vula, 2013).

Kriminaliteti kompjuterik paraqitet në kushtet e reja të automatizimit, kështu që për kryerjen e tij nevojitet kohë e shkurtër që mund të matet me minuta dhe sekonda, e në raste të caktuara edhe pjesë të sekondave. Një ndër karakteristikat kriminalistike është se kryesit e veprave penale të kriminalitetit kompjuterik nuk mund të njëjtësohen me kryesit e formave klasike të kriminalitetit, për shkak të specifikave të ndryshme të cilat i veçojnë në kryerjen e llojit të këtyre krimeve. Andaj, me shfrytëzimin e teknikës kompjuterike, veprat e caktuara penale si: mashtrimet, shpërdorimet dhe spiunazhi, marrin forma me shkallë të lartë të rrezikshmërisë shoqërore, kurse në anën tjetër, paraqiten forma të reja të sjelljeve kriminale që nuk janë të inkriminuara si vepra penale (Latifi, 2014).

Përveç, nocionit të kriminalitetit kompjuterik dhe karakteristikave të tij, rëndësi të veçant ka edhe format e paraqitjes së kriminalitetit kompjuterik. Sipas autorit William Sessions format themelore të kriminalitetit kompjuterik janë: vjedhjet, asgjësimi i pasurisë, mashtrimet, vjedhjet e imta dhe qëllimet keqbërëse, duke nënkuptuar me kriminalitet kompjuterik atë veprim me të cilin përsone i paautorizuar futet në sistemin kompjuterik (Gashi, 2014). Andaj, kriminaliteti kompjuterik apo siç njihet ndryshe krimi i “jakës së bardhë”, ndahet në disa format dhe ato janë:

- 1) **Mashtrimet kompjuterike** – janë forma të vjetra të keqpërdorimit të kompjuterit të cilat kryhen me qëllim që vetit ose të tjerëve t'u krijohej pasuri ose përfitim tjetër në mënyrë të paligjshme, ashtuqë nuk vihet në mashtrim ndonjë përsone si te rastet e mashtrimeve të zakonshme, por mashtrimi ka të bëjë ekskluzivisht me kompjuterin në të cilin futen të

dhënat e pasakta dhe nuk futen të dhënat e sakta. Këto mashtrime kompjuterike paraqiten tek: sigurimet, taksat dhe tatimet, fondet pensionale, ndihmat sociale, kompanit e sigurimeve etj. Në këtë formë, një punonjëse në terminalin e një agjencie të sigurimit pensional në Amerikë, i'a kishte përshtatur vetës që t'i marrë kambialet e pensioneve të 30 përsoneve të ndryshëm (*Veton Vula, 2018*). Pra, këto mashtrime janë të mundëshme në çdo sistem ekonomik ose afarizëm tjetër në të cilën shfrytëzimi kompjuterik mund të ndikojë në ecurinë e distribuimit të parave (*Gashi, 2014*).

- 2) **Sabotazhi kompjuterik** – është veprimtari tjetër kriminale, e cila kryhet me qëllim që të pengohet shfrytëzimi i sistemit kompjuterik dhe resureve të tij. Në këtë kategori hyjnë veprimet që kanë të bëjnë me fshirjen, ndërrimin dhe shkatërrimin e programeve dhe të dhënave kompjuterike si dhe veprimtarive tjera të drejtuara në bazën teknike të sistemit informatikë (*Vula, 2013*). Sipas autorit Milovanovic kjo formë e kriminalitetit është e rrezikshme ngase mund të jetë e orientuar në sisteme të mëdha kompjuterike të institucioneve të ndryshme shtetërore ose organizatave ekonomike. Në SHBA, ish shefi i dizajnit të programit të rrjetit kompjuterik të kompanis “Omega” , është dënuar për veprën penale të sabotazhit kompjuterik, pasi që ka shlyer të gjitha dizajnet dhe programet e prodhimit të masave prodhuese të teknologjisë së lartë dhe instrumenteve tjera kontrolluese nga të përdorura nga NASA (*Veton Vula, 2018*).
- 3) **Vjedhja e informacioneve** – konsiderohet si një nga format më të shpeshta të kriminalitetit kompjuterik. Rrezikshmëria që kjo formë shkakton nuk është e vogël në krahasim me ato që u përkasin mashtrimeve kompjuterike. Formë e veçantë të vjedhjes së informacioneve që paraqesin kopjimi ilegal i programeve shtëpiake dhe personale kompjuterike, vjedhja dhe kopjimi i pajisjes kompjuterike, si dhe vjedhja e kohës kompjuterike. Kryersit e këtyre veprave janë kryesisht operatorët kompjuterik, të cilët e keqpërdorin vendin e tyre të punës, duke ndërmarrë aktivitete të drejtuara në fitimet e tyre personale (*Gashi, 2014*).

Karakteri specifik i kriminalitetit kompjuterik, rrezikshmëria e tij e madhe shoqërore dhe rritja e përhershme e keqpërdorimit të kompjuterit përmes formave të lartëcekura kërkojnë që kjo problematikë të rregullohet me dispozita të caktuara ligjore me qëllim të luftimit dhe parandalimit të kësaj forme të kriminalitetit (*Gashi, 2014*). Për parandalimin dhe luftimin e krimit kompjuterik, shumë shtete po bëjnë përpjekje për të gjetur mjete, metoda dhe masa sa më efikase. Autori U. Sieber, ka konstatuar se:” si përgjigje ndaj numrit gjithnjë e më të madh të ndërhyrjeve të pa autorizuara në sistemet kompjuterike veprave të “hakingut”, shumë

shtete kanë aprovuar ligje të reja me të cilat inkriminohet ndërhyrja e paligjshme në sistemet e huaja kompjuterike (*Veton Vula, 2018*).

Andaj, duke parë rrezikun e rrjeteti kompjuterik dhe informatave elektronike antarët e Këshillit të Evropës më 23 nëntor 2001, në Budapest kanë aprovuar Konventën evropiane mbi krimin kompjuterik dhe sipas saj shtetet antare të Këshillit të Evropës duhet të inkorporojnë në ligjet e tyre penale vendore të gjitha veprave penale të cilat kanë të bëjnë me keqpërdorimin e kompjuterit (*Konventa e Këshillit të Evropës mbi kriminalitetin kompjuterik, 2001*).

Në vazhdim do të sjellim disa nga ligjet dhe kodet penale që kanë të bëjnë me rregullimin e çështjeve nga aspekti juridiko-penale i problemeve nga fusha e kriminalitetit kompjuterik.

Me Ligjin mbi keqpërdorimin e kompjuterëve në Britanin e Madhe janë paraparë veprat penale kompjuterike specifike. Duke respektuar Konventën e Këshillit të Evropës për inkrimimin e veprave penale në lidhje me keqpërdorimin e kompjuterit, Britania e Madhe ka specifikuar këto vepra. Në rend të parë, e kombinon veprën penale të hakingut me format më të rënda të kualifikimit, pamarrë parasysh se a është bërë ndërhyrje në sistemin kompjuterik. Andaj, mund të vërehen dy lloje të veprave penale, e para quhet “vepër penale themelore e hakingut”, dhe “vepër e largët e hakingut” (*Veton Vula, 2018*).

Sa i përket Ligjit Penal të Austrisë, deri në vitin 1987 nuk ka pasur ndonjë normë të posaçme mbi sanksionimin e veprave penale të kriminalitetit kompjuterik, pasi që Austria konsiderohet një nga shtetet e rralla e cila nuk e ka sanksionuar këtë vepër penale. Autori D. Dragicevic konstaton se: “me rastin e kryerjes së reformave në Ligjin Penal të Austrisë, është dashur që përgjegjësit juridiko-penale të zgjerohen edhe në veprat tjera, të cilat paraqesin rrezik gjithnjë e më të madh në çdo mjedis të zhvilluar”. Mirëpo, vlen të theksohet se Austria ka pranuar reformat ligjore sipas rekomandimit të Këshillit të Evropës (*Veton Vula, 2018*).

Ndërsa, Ligji Penal i Gjermanisë nuk ka paraparë në mënyrë të detajuar veprat e krimit kompjuterik, mirëpo në vitin 1986 është aprovuar Ligji mbi ndalimin e kriminalitetit ekonomik në të cilin janë inkorporuar edhe veprat penale nga fusha e kriminalitetit kompjuterik duke përfshirë: vjedhjen e të dhënave, mashtrimin kompjuterik, falsifikimin kompjuterik dhe forma tjera të paraqitjes së krimit kompjuterik. Njësoj, sikurse në Britani të Madhe dhe Austri, Konventa e Këshillit të Evropës me rekomandimet e saj ligjore ka gjetur zbatim edhe në legjislacionet e Gjermanisë (*Veton Vula, 2018*).

Gjithashtu, Kodi Penal Francez, Ligji Penal i Polonisë dhe Ligji Penal i Kroacisë kanë pranuar dhe zbatuar në tërësi rekomandimet nga Konventa e Këshillit të Evropës (R/9/89). Në këto legjislacione janë të parapara pothuajse veprat e njejta të kriminalitetit kompjuterik siç janë: mashtrimi kompjuterik, falsifikimi i të dhënave kompjuterike, ndalimi i përdorimit të të dhënave personale, sabotazhi kompjuterik e forma të tjera (*Veton Vula, 2018*). Trajtimin e veprave penale të kriminalitetit kompjuterik e ka trajtuar dhe hetuar edhe FBI dhe sipas konstatimit të tyre egzistojnë tri grupe të caktuara të cilat paraqesin kanosje eksterne me keqpërdorimin e kompjuterik duke vjedhur apo shkatrruar ndonjë të dhënë (*Veton Vula, 2018*).

Krimi kibernetik do të jetë një prej sfidave për institucionet e Republikës së Kosovës në të ardhmen e afërt. Republika e Kosovës ka ndërmarrë hapa konkret në krijimin e infrastrukturës ligjore për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit kibernetik, por ende mbetin shumë sfida, sidomos në kuptimin teknik të përballimit të suksesshëm me këtë formë të krimit, që në Kosovë është fenomen relativisht i ri (*Strategjia Shtetërore për sigurinë kibernetike dhe plani i veprimit , 2016-2019*). Si Kodi Penal i Republikës së Kosovës e poashtu edhe Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimeve Kibernetike nuk e njohin krimin kibernetik si një vepër penale të vetme, por, janë disa vepra që hyjnë në krimet kibernetike.

Veprat penale sipas Kodit Penal i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013 dhe është shfuqizuar më 14 janar 2019:

- Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi;
- Keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit;
- Hyrja në sistemet kompjuterike;
- Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes

Sipas Policisë së Kosovës janë paraqitur disa raste dhe asistime për kryerjen e krimit kibernetik.

Tabela 1.3. Rastet dhe asistimet në krimin kibernetik të paraqitura nga Policia e Kosovës.

Vitet	2016	2017	2018
Raste	40	42	35
Asistime	152	199	150

Rastet kanë të bëjnë me hyrje në sisteme kompjuterike (sulme ndaj ueb-faqeve dhe platformave të ndryshme), keqpërdorim i kartelave bankare dhe të kreditit (vjedhja e të dhënave bankare të klientëve të bankave përmes vendosjes së pajisjeve të modifikuara si dhe klonimi dhe përdorimi i kartelave bankare apo të kreditit) si dhe shkarkim dhe shpërndarje e materialeve me abuzim seksual të fëmijëve përmes internetit. Këto raste janë trajtuar në nivel qendror.

Asistimet i referohen rasteve që janë trajtuar në nivel stacioni dhe rajoni brenda Policisë së Kosovës në të cilat Sektori për Hetime të Krimeve Kibernetike ka asistuar. Gjithashtu, asistimet nënkupton kryerjen e veprave penale (raste) të mundësuar nga sistemet kompjuterike.

Në nenin 327, Hyrja në sistemet kompjuterike thuhet: 1. “ Kushdo që pa autorizim dhe me qëllim që të përfitojë në mënyrë të kundërligjshme dobi pasurore për vete apo personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër, ndryshon, publikon, shlyen, asgjëson apo shkatërron të dhënat apo programet kompjuterike ose në ndonjë mënyrë tjetër hyn në sistemin kompjuterik të tjetrit, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në (3) tre vjet. 2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumë prej dhjetëmijë (10.000) Euro ose me dëm material që tejkalon shumë prej dhjetëmijë (10.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet” (*Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2019*). Mirëpo, përveq KRPK, fusha e kriminalitetit kompjuterik në Kosovë mbulohet edhe me Ligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kompjuterik, i cili parasheh parandalimin dhe luftimin e krimit kompjuterik me masakonkrete, zbulimin dhe sanksionimin e shkeljeve përmes sistemeve kompjuterike duke ofruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Meqenëse, Kosova nuk është antare e Këshillit të Evropës, Konventa e Evropës për krimin kompjuterik dhe protokolle shtesë të Konventës së Evropës për krimin kompjuterik, penalizimin e akteve me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryerka nëpërmjet sistemeve kompjuterik nuk mund të aplikohen në Kosovë (*Veton Vula, 2018*).

2.7. Luftimi dhe parandalimi i kriminalitetit të organizuar

Parandalimi i krimit është koncept i cili duhet të zhvillohet në institucionet lokale, fillimisht në nivel të ulët, ku krimi kryesisht ka për cak bashkësinë (*Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalim të krimit dhe plani i veprimit, 2013-2017*). Ndaj kriminaliteti të

organizuar si një dukuri tejet e rrezikshme kriminale shoqërore me përmasa jo vetëm nacionale, por edhe ndërkombëtare, shtetet e ndryshme janë të interesuara që të përdorin masa dhe mjete të ndryshme në luftim dhe parandalimin e tij. Gjatë këtij punimi do të trajtohen disa nga masat dhe mjetet të cilat janë të zbatueshme në karakterin nacional dhe ndërkombëtar për luftimin e kriminalitetit të organizuar (*Latifi, 2012*).

Parandalimi i kriminalitetit përfshin aktivitetet e subjekteve të ndryshme që nënkuptojnë masat preventive. Masat e tilla të parandalimit të kriminalitetit mund të nënkuptojnë: forumet shtetërore dhe forumet me autorizime publike, organizatat joqeveritare, shoqatat, fondacionet private, institucionet e informimit publik, shtypin, mediat elektronike, institucionet edukative, përkatësisht arsimore, rrethin profesional në kuptimin më të gjerë të fjalës, institucionet fetare, familjen si grup fundamental social të çdo shoqërie. Me masat e parandalimit të kriminalitetit nënkuptojmë aktivitetet e organeve shtetërore dhe të organeve të tjera të orientuara në pengimin e dukurive negative shoqërore, që prodhojnë pasoja të ndaluara dhe të dëmshme, dhe krijojnë kushte për luftimin e tyre. Diferencimi i masave të parandalimit shoqëror të kriminalitetit zbatohet duke pasur parasysh aspektin e qëllimit të orientimit kriminalistik të shteteve përkatëse. Detyrë themelore e politikës së luftimit të kriminalitetit është organizimi i luftës dhe mbrojtjes efektive nga kriminaliteti në dy rrafshë: parandalimi dhe represioni juridiko-penal dhe parandalimi i përgjithshëm social (*Latifi, 2012*).

Politika bashkëkohore e parandalimit të kriminalitetit përpiqet që strategjinë shoqërore të kundërvënies ndaj kriminalitetit ta vendosë në disa parime të caktuara themelore dhe këto parime janë:

- 1) **Parimi i ligjshmërisë** – nënkupton që çdo aktivitet i cili ka për qëllim kundërvënien ndaj kriminalitetit dhe masat që duhet ndërmerren në pajtim me normat ligjore që kanë të bëjnë me aktivitetet e tilla (*Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalim të krimit dhe plani i veprimit, 2013-2017*). Çdo aktivitet në këtë fushë duhet të ketë bazën ligjore si dhe në dispozitat tjera juridike që kanë të bëjnë me atë materie (*Vula, 2013*). Aplikimi i këtij parimi është i domosdoshëm në mënyrë që të shmangët arbitrariteti i mundshëm në veprimin preventiv, para se gjithash në ato sfera të jetës ku mund të rrezikohen ose të cenohen liritë dhe të drejtat e qytetarëve. Pra, parimi i ligjshmërisë si parim themelor kushtetues dhe ligjor, nënkupton se askush nuk mund të dënohet për veprë para se të jetë kryer, nëse nuk ka qenë e paraparë me

ligj si veprë penale dhe nëse nuk ka qenë me ligj e paraparë se si do të denohet ai që e kryen (*Latifi, 2012*).

- 2) ***Parimi i legjitimitetit*** – aplikohet në ato situata në të cilat bëhet kufizimi i lirive dhe të drejtave të njeriut dhe imponon që të gjitha kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut të jenë të harmonizuara me aplikimin e masave dhe të veprimeve preventive (*Vula, 2013*). Ky parim i politikës së luftimit të kriminalitetit nënkupton zbatimin e detyrimit penalo-juridik vetëm ndaj asaj sjellje e cila është aq e dëmshme për vlerat e mbrojtura me kushtetutë, sa që mbrojtja e tyre nuk mund të realizohet pa forcën e tillë dhe për shkak të veprës penale, kufizimin e përmbajtjes së sanksioneve penalo-juridike dhe mënyrës së zbatimit të tyre ndaj kryesësit të veprës penale vetëm në masën e cila i përgjigjet llojit të sanksionit penalo-juridik dhe qëllimet e tij të posaçme, kufizimin në suaza të fajësisë dhe të moshës së kryesit, kufizimin e detyrimit penalo-juridik vetëm në suaza të kryesit të veprës penale (*Latifi, 2012*).
- 3) ***Parimi i individualizimit*** – nënkupton një raport mjaft të harmonizuar të faktorëve individual dhe shoqëror të kriminalitetit dhe paraqet rëndësi të jashtëzakonshme, sepse mbështetet në nevojat dhe kushtet konkrete individuale të aplikimit dhe konsiderohet kusht për suksesin e çdo veprimi preventiv (*Vula, 2013*).
- 4) ***Parimi i humanizmit*** – në veprimtarin e luftimit të kriminalitetit janë të domosdoshme këmbëngulja dhe vendosmëria, kufizimet dhe masat e detyrueshme, por ato janë gjithnjë në pajtim me detyrat dhe karakterin e shoqërisë demokratike. Ky parim ka të bëjë me masat që i aplikojnë organet përkatëse shtetërore dhe organet e judikaturës në bazë të autorizimeve të veta kushtetues dhe ligjore. Aplikimi i këtyre masave ndërmerret me respektimin e integritetit fizik dhe psikologjik të personalitetit, të dinjitetit dhe të prestigjit të tij. Andaj, humanizmi nuk duhet të jetë qëllim i vetëvetës, por duhet të kontribuojë në luftimin e kriminalitetit dhe të ndikojë pozitivisht në moralin dhe sjelljen e qytetarëve (*Latifi, 2012*).

Në teorinë bashkëkohore parandalimi është e mundur të ndahet sipas tri qasjeve të ndryshme të cilat korrespondojnë me ndarjen në mbrojtjen primare shëndetësore duke pasur parasysh zonën e veprimit. Parandalimi primarë i kriminalitetit realizohet me përmisimin e kushteve të përgjithshme sociale dhe menjanimin e shkaqeve të cilat ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit. Zakonisht, parandalimi primarë i kriminalitetit zbatohet në mënyrë primare ndaj të miturve, të të papunëve dhe kategorive të rrezikshme. Parandalimi sekondarë i kriminalitetit konsiderohet objekt në të cilin më shpesh fokusohet policia dhe nënkupton

identifikimin e zonës brenda bashkësisë lokale me shkallën më pak ose më shumë të shprehur të kriminalitetit dhe aplikimi i parandalimit sekondar përforcon aspektet insituacionale, interaktive të veprave përkatëse penale dhe në këtë mënyrë përpiqet t'i zvogloj rrethanat për kryerjen e veprave penale. Parandalimi terciarë paraqet programet për parandalimin e kriminalitetit dhe këto programe janë të fokusuara ndaj njeriut, individëve të cilët janë të dënuar për veprën penale dhe vazhdojnë ta kenë statusin e kërcënimit të rëndësishëm ndaj shoqërisë me të gjitha masat e paralajmërimit që janë ndërmarrë nga ana e institucioneve përkatëse (Vula, 2013).

Kontrolli mbi kriminalitetin në përgjithësi është një nga angazhimet kryesore të kriminologjisë bashkëkohore. Me këtë rast janë aplikuar mjete dhe masa të ndryshme të cilat ndikojnë në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Në nivelin ndërkombëtar, janë ndërmarrur disa nisma legjislative në fushën e luftimit dhe parandalimin e kriminalitetit të organizuar. Konventa dhe dispozita tjera ligjore janë aprovuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian (Gashi, 2014).

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtarë, e cila është miratuar nga OKB në vitin 2000 (*Përmbledhje e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ligjore Ndërkombëtare*, 2016), konsiderohet një nga konventat më të njohura në fushën e luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit të organizuar. Kjo konventë potencon obligimin e shteteve për inkriminimin e veprave të rënda penale, transicionale, korrupsionin, larja e parave dhe obstrukcion i drejtësisë të kryera nga ana e grupit kriminal të organizuar (Gashi, 2014).

Gjithashtu, OKB në vitin 1988 ka miratur edhe të ashtuquajturën Konventën e Vjenës apo Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave dehëse dhe lëndëve psikotrope (*Përmbledhje e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ligjore Ndërkombëtare*, 2016). Kjo konventë obligon shtetet antare që të marrë masat e nevojshme, duke përfshirë masat legjislative dhe administrative me qëllim që të trajtojnë në mënyrë efikase aspektet e ndryshme të trafikimit të paligjshëm të drogave (Gashi, 2014). Përveç kësaj, egziston edhe Konventa mbi drogat narkotike e cila u ndryshua me Protokollin e vitin 1972 mbi drogat narkotike. Sipas kësaj konvente, shtetet antare janë të obliguara që t'i zbatojnë dispozitat e kësaj konvente si dhe të kufizojnë vetëm për qëllime mjeksore dhe shkencore prodhimin, fabrikimin, eksportin, importin, shpërndarjen, tragtimin dhe zotërimin e drogave (Gashi, 2014).

Kontributin më të madh në luftimin e kriminalitetit të organizuar në nivel evropian kanë dhënë dy nga organizatat ndërkombëtare siç janë: Bashkimi Evropian dhe Këshilli Evropës. Megjithatë, Këshilli Evropës ka edhe një varg insitucionesh të tjera të cilat ndikojnë në parandalimin e përhapjes së kësaj fushe. Këto institucione janë: Instituti Evropian për parandalimin e krimit dhe kontrollit, Qendra e përbashkët e kërkimit për krimin transnacional, Qendra për informimin dhe studimin e krimit të organizuar (*Gashi, 2014*).

Në Republikën e Kosovës janë të parapara mjete dhe masa të ndryshme në procesin e luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit të organizuar. Fillimisht, kriminaliteti i organizuar si dukuri shoqërore është munduar të luftohet me anë të Rregulloreve të UNMIK-ut, mirëpo me krijimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, këto rregullore janë inkorporuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Kodin e Procedures Penale të Kosovës dhe disa dispozita të këtyre rregulloreve janë shëndrruar në ligje të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (*Gashi, 2014*).

Kodi Penal i Republikës së Kosovës përmban dispozita të posaçme lidhur me kriminalitetin e organizuar. Në pjesën e përgjithshme gjenden dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me bashkimet kriminale, e cila konsiderohet një nga format më të cilën paraqitet kriminaliteti. Për më tepër, pjesa e përgjithshme parasheh edhe ndëshkime për këto grupe kriminale dhe antarët e tyre. Ndërsa, në pjesën e posaçme KPRK-së, përkatësisht kapitullin XXIV gjenden dispozitat të cilat kanë të bëjnë me veprat penale të cilat kryhen në mënyrë të organizuar. Këto dispozita trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me format e kryerjes së krimit të organizuar dhe dënimet që mund të shqiptohen ndaj këtyre kryersve (*Gashi, 2014*).

Për më tepër, politika kriminale e një shteti duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit të organizuar duhet të orientohet edhe në hartimin e strategjive të ndryshme. Disa strategji të miratuara nga Republika e Kosovës janë:

1. Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit 2012 – 2017 (*Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit , 2012-2017*) ;
2. Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalim të krimit dhe plani i veprimit 2013 – 2017 (*Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalim të krimit dhe plani i veprimit, 2013-2017*);
3. Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit 2012 – 2017 (*Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit , 2012-2017*);

4. Strategjia kundër korrupsionit 2013 – 2017 (*Strategjia kundër korrupsionit , 2013-2017*);
5. Strategjia Shtetërore për sigurin kibernetike dhe plani i veprimit 2016 – 2019 (*Strategjia Shtetërore për sigurin kibernetike dhe plani i veprimit , 2016-2019*);
6. Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër narkotikëve dhe plani i veprimit 2012 – 2017 (*Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër narkotikëve dhe plani i veprimit , 2012 – 2017*);
7. Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë 2015 – 2019 (*Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë , 2015 – 2019*);
8. Strategjia shtetërore kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit 2018-2022 (*Strategjia shtetërore kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit, 2018-2022*).

2.8. Mekanizmat ligjor dhe insitucional për trajtimin e kriminalitetit të organizuar

Për trajtimin, luftimin dhe kriminalitetit të organizuar janë miratuar një numër i madh i legjisacioneve, strategjive, konventave të cilat rregullojnë këtë fushë. Mirëpo, përveç legjisacioneve të ndryshme egzistojnë edhe mekanizma të ndryshëm insitucional që ndikojnë në mënyrë direkte dhe indirekte në trajtimin e kriminalitetit të organizuar.

Trajtimi i kriminalitetit të organizuar përveq KPP, KPRK-së dhe disa legjisacioneve të lartëcekura, trajtohet edhe nga disa ligje të tjera të posaçme të cilat janë miratuara në Kuvendin e Kosovës me qëllim të parandalimit dhe luftimit të tij përmes masave dhe sanksioneve.

Ligji për kompetencat e zgjeruara dhe konfiskimin e pasurisë së përfituar ke vepra penale, i miratuar në vitin 2013 (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2017*) paraqet një akt juridik i cili përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar nga personat që kanë kryer vepër penale. Dispozitat e këtij ligji janë plotsësim i dispozitave të Kodit të Procedurës Penale (*Gashi, 2014*).

Duke u mbështetur në këtë ligj dhe Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Agjencia për menaxhimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara paraqet këto statistika:

Tabela 1.4. Konfiskimi dhe sekuestrimi i pasurive të luajshme.

Pasuri të luajshme të konfiskuara					
Numër	Data e pranimit	Lloji	Në detaje	Statusi	Viti konfiskimit
41	16.05.2016	Mjet transportues	BMW X5, 01-414-Dr	Konfiskim	2016
74	04.10.2016	Tjera	Telefona të ndryshëm	Konfiskim	2016
80.1	31.10.2016	Tjera	Iphone 6 një copë, samsung dy copë	Sek-Konfiskim	2018
98.2	30.12.2016	Mjet transportues	Mercedes 250D	Konfiskim	2017
14.2	08.02.2017	Mjet transportues	Daimler Chrysler B200 CDI	Sek-Konfiskim	2019
44.0	04.04.2017	Mjet transportues	VW Golf IV	Sek-Konfiskim	2017
49.1	06.04.2017	Mjet transportues	Pick Up Peugeot	Sek-Konfiskim	2017
57.1	27.04.2017	Mjet transportues	Mercedes C220 CDI	Sek-Konfiskim	2019
86.5	07.11.2017	Tjera	8 shtëpiza, 3 llaptop, 2 DVR, 1 telefon mobil	Konfiskim	2017
87.3	13.10.2017	Tjera	Makinë për paketim, peshore digjitale	Sek-Konfiskim	2018
		Mjet	Jeep Grand		

91	26.10.2017	transportues	Cherokee	Konfiskim	2018
97	10.11.2017	Mjet transportues	Peugeot	Konfiskim	2018
17.1	27.03.2018	Mjet transportues	Mercedes Daimler Chrysler	Konfiskim	2018
17.2	27.03.2018	Mjet transportues	Peugeot 406	Konfiskim	2018
77.1	27.12.2018	Mjet transportues	Alfa Romeo 14	Konfiskim	2018

Tabela 1.5. Konfiskimi dhe sekuestrimi i pasurive të paluajtshme.

Numër	Data e pranimit	Vendimi	Data e vendimit	Lloji	Në detaje	Statusi	Viti i konfiskimit	Vendi - statusi
86	18.10.12	GJQP. PP180/12		Patundshmëri	Restorant "Nata"	Konfiskim	2016	Babush i Muhaxherëve
97	16.11.12	GJPP. nr.283/12		Patundshmëri	Banesë	Konfiskim	2018	Prishtinë
98	20.11.12	GJPP. nr.283/12		Pafundshmëri	Banesë 36m ²	Konfiskim	2018	Klinë
99	20.11.12	GJPP. nr.283/12	06.11.12	Paluajtshmëri	Lokal	Konfiskim	2018	Klinë
67	04.12.14	GJTH.P.nr. 280/14		Paluajtshmëri	Shtëpi	Konfiskim	2017	Rosujë, Pejë
6-1	09.02.15	PPS.nr. 42/14		Paluajtshmëri	Banesë	Konfiskim	2016	Prishtinë
36	28.04.16	GJTH.PKR .1046/13	13.04.16	Paluajtshmëri	Banesë 100.08 m ²	Konfiskim	2016	Prishtinë
1.1	13.01.17	GJA. PAKR.nr. 351/16	25.10.16	Paluajtshmëri	Banesë 95.68 m ²	Konfiskim	2017	Ferizaj
		GJA. PAKR.nr.3			Tokë 3,04			

1.1o	25.04.17	51/16	25.10.16	Paluajtshmëri	ari	Konfiskim	2017	Shtërpicë
1.XI	25.07.17	GJA. PAKR.nr.3 51/16	25.10.16	Paluajtshmëri	Banesë 111 m ²	Konfiskim	2017	Ferizaj
1.XII	28.07.17	GJA. PAKR.nr.3 51/16	25.10.16	Paluajtshmëri	Tokë 12,540 m ²	Konfiskim	2017	Babush i sërbeve
80.0	26.07.17	GJTH. Nr. 1046/	18.12.14	Paluajtshmëri	Banesë 66 m ²	Konfiskim	2017	Prishtinë

Tabela 1.6. Administrimi i pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara gjatë viteve në total.

Viti	Sekuestrim	Konfiskim	Ngrirje	Total	Kthime gjatë viteve
2011	41,410.34 €	27,390.94 €		68,801.58 €	
2012	1,373,865.9 €	1,194,038.21 €		2,567,904.13 €	141,500.00 €
2013	543,827.1 €	3,807.17 €	1,000,000.00 €	1,547,634.27 €	142,488.35 €
2014	21,179,215.71 €	70,863.91 €	2,310,000.00 €	23,560,079.62 €	65,850.00 €
2015	1,417,293.6 €	165,857.71 €	1,120,990.26 €	2,704,141.65 €	2,584,630.22 €
2016	3,034,109.5 €	128,202.49 €		3,162,312.04 €	858,190.94 €
2017	960,043.91 €	465,123.78 €		1,425,167.69 €	57,654.40 €
2018	625,641.67 €	51,954.00 €		704,595.64 €	263,555.12 €
	29,202,408.18 €	2,107,328.21€	4,430,990.26 €	35,740,636.65 €	4,113,779.03 €

Si masë e rëndësishme në pengimin e përfshirjes së zyrtarëve të lartë publik në forma të kriminalitetit të organizuar, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik rregullon në mënyrë të detajuar deklarimin e pasurisë, të ardhurave, përfitimeve materiale dhe dhuratat e zyrtarëve publik. Për këto shkelje të detyrimeve janë paraparë edhe ndëshkimet (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2017*), ndërsa Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, të miratuar në vitin 2008 (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës,*

2017) paraqet një nga aktet më të rëndësishme në trajtimin, luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Përmes këtij ligji dhe dispozitave të tij përcaktohen kompetencat prokurorisë që ajo ka në ndjekjen dhe hetimin e llojeve më të rënda të veprave penale, duke përfshirë edhe kriminalitetin e organizuar. Qëllimi i këtij ligji është shqiptimi i sanksioneve penale dhe masave tjera ndëshkuese ndaj shkelësve të ligjit.

Për trajtimin e kriminalitetit janë miratuar edhe shumë konventa tjera ndërkombëtare, mirëpo dy nga konventat më të rëndësishme janë:

- 1) Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokollet shtesë të saj (*Përmbledhje e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ligjore Ndërkombëtare, 2016*)
- 2) Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (*Përmbledhje e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ligjore Ndërkombëtare, 2016*)

Në trajtimin, parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit të organizuar merren organe dhe institucione shtetërore apo jo shtetërore. Për trajtimin e kësaj dukurie shoqërore duhet përmendur edhe krijimin e strukturave të specializuara të kriminalitetit të organizuar dhe kualifikimin e tyre me qëllim të luftimit dhe parandalimit të tij (*Vula, 2013*).

Mekanizmat e tillë institucional të cilët trajtojnë format e kriminalitetit të organizuar janë:

- 1) ***Policia e Kosovës*** – roli i këtij organi shtetëror që kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, mbajtjen e rendit të qetësisë publike si dhe sigurimin e rendit të caktuar shtetërorë është shumë i rëndësishëm. Funksionimi i policisë është i përafërt me institucionet e judikaturës, kur merret parasysh funksionimi dhe aktiviteti i tij, sepse regjistron veprën penale, e vlerëson dhe e ndjek gjendjen dhe peshën e kriminalitetit dhe metodat e veprimit të delikuentëve. Andaj, policia është e obliguar t'i identifikojë grupet kriminale dhe të ndër marrë masa për kapjen e tyre. Qëllimi i Policisë së Kosovës është pengimi i kryerjes së veprave penale nga ana e këtyre grupeve kriminale, nga e sjellje e të cilëve mund të parashikohet sjellja kriminale, devijuese dhe paradelikente. Në kuadër të Policisë së Kosovës funksionon edhe Drejtoria kundër krimit të organizuar, e cila ka për qëllim në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Për më tepër, Policia e Kosovës përmes veprimtarisë së saj është në mbrojtje të ligjit dhe trajtimin e kriminalitetit të organizuar dhe të ndihmojë autoritetet gjyqësore (prokurorin dhe gjykatën) që ti kryej veprimet e veta

ligjore pa ndërpreje, sepse pa bashkëpunimin e këtyre tri institucioneve do të dështonin iniciativat ligjore (*Latifi, 2013*).

- 2) **Prokuroria e Kosovës** – është organ i shtetit që vepron në interesin publik apo të shtetit dhe qëllimi saj është ndriçimin e rasteve penale. Sipas Ligjit për Prokurorin e Shtetit: “prokurori i shtetit nënkupton institucionin e pavarur kompetent dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale dhe veprave tjera të parapara me ligj” (*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2017*). Zakonisht, gjatë punës së prokurorisë zbatohet parimi i ligjshmërisë sepse puna e prokurorisë është e lidhur ngushtë me punën e gjykatave (*Latifi, 2013*). Duke parë mungesën e legjislacionit, prokurori i shtetit mund të ndihmojë shumë përmes përcaktimit të politikave të kriminalitetit të organizuar, duke dhënë sygjerime dhe vërejtje për legjislacionin aktual.
- 3) **Gjykatat e Kosovës** – Praktika e gjykatave është e ndërlidhur me legjislacionin penal dhe mbështetet në zgjidhjet ligjore në procesin e luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit dhe të shqiptimit të sanksioneve penale. Politika gjyqësore, buron nga politika ligjdhënëse, duke u gërshetuar njëkohësisht edhe me qarqet dhe solucionet e saj. Kjo nënkupton zbatimin normativ të rasteve të inkriminuara (*Latifi, 2013*). Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale dhe të paanshme, me qëllim që sistemi gjyqësor të jetë sa më efikas në luftë kundër krimit të organizuar dhe formave tjera të kriminalitetit. Gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve gjykatat janë të pavarura, të paanshme, të pa ndikuara në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizike apo juridik, përfshirë edhe organet publike (*Strategjia shtetërore kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit, 2018-2022*). Gjykatësi është i obliguar të respektoj gjatë procesit elementet e domosdoshme dhe subjektive , andaj gjykimin duhet ta harmonizoj me konceptin e risocializimit, si qëllim themelor të dënimit, i cili aplikohet në të gjithë botën bashkëkohore (*Latifi, 2013*)

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Ashtu siç shihet nga të gjitha statistikat e paraqitura gjatë këtij punimi, Kosova ndër vite ka pasur rritje të veprave penale të kryera në formë të kriminalitetit të organizuar. Kjo nënkupton se përkundër angazhimit të organeve shtetërore dhe institucioneve të drejtësisë për trajtimin e kriminalitetit të organizuar, kjo dukuri ka vazhduar të rritet dhe shkaqet kryesore të cilat ndikojnë në mënyrë indirekte në paraqitjen dhe rritjen e kriminalitetit të organizuar konsiderohen faktorët ideo-politikë të kriminalitetit.

Varfëria dhe skamja janë një nga problemet kryesore të cilat ndikojnë në paraqitjen dhe rritjen e kriminalitetit, sepse kjo dukuri është produkt i shtresave të varfëra të popullësisë. Ndër të tjera, shkaqet ekonomike mund të ushtrojnë ndikim në sjelljet dhe qëndrimet e individëve e disa individëve sidomos të disa individëve të cilët janë të zhytur në veprime dhe sjellje kriminale. Arsimimi është një faktorë më rëndesi në formimin dhe aftësimin e personalitetit të njeriut për jetë më të sigurt dhe me të suksesshme. Nga ana tjetër personat e paarsimuar më vështirë mund të kyçen në shumë procese jetësore, sepse atyre u mungon aftësia për të kuptuar dhe gjykuar drejtë pasojat e veprimeve të ndryshme të ambientit shoqëror. Në Kosovë, numërin më të madh të veprave penale në formë të krimit të organizuar, e kryejnë personat me arsim të ulët dhe analfabet. Janë të rrallë personat me arsim të lartë të cilët kryejnë krime të tilla.

Mirëpo, përkundër rritjes së veprave penale të kryera në formë të krimit të organizuar dhe miratimit të akteve juridike të trajtuar gjatë këtij punimi konsiderojmë se nuk është punuar sa duhet në lidhje me trajtimin, luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit të organizuar. Në Republikën e Kosovës, ku krimi i organizuar paraqet kërcënim për shtetin, është e nevojshme miratimi i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me masat, mjetet dhe metodat në trajtimin, luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit të organizuar. Miratimi i Ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar apo ligji “antimafia” do të ndikonte në parandalimin e kriminalitetit dhe goditjen e tij përmes konfiskimit të pasurisë së përsoneve të fituar përmes veprimtarive kriminale dhe do të zbatohet ndaj atyre përsoneve qofshin përsone fizik apo juridik të cilët dyshohen se janë pjesë e organizatave dhe grupeve kriminale.

4. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij hulumtimi janë të shumëllojshme, varësisht prej rrethanave dhe nevojave të studimit të këtij punimi. Përmes këtyre metodave trajtohet problematika e kriminaliteti të organizuar, karakteristikat dhe format e paraqitjes së tij. Metodatat e përdorura janë: metoda statistikore, metoda historike, metoda e studimit të rasteve individuale, metoda juridike.

Metoda historike është përdorur me qëllim që gjatë këtij hulumtimi të paraqiten fillesat e para të kriminalitetit të organizuar dhe mënyra e zgjerimit të tij në të gjitha vendet e botës.

Gjatë hulumtimit dhe trajtimit të dukurisë së kriminalitetit të organizuar, kam përdorur metodën e studimeve të rasteve individuale, për t'iu qasur këtij fenomeni si dukuri individuale dhe në fokus të interesimit të grupeve apo organizatave të ndryshme ka qenë fitimi i pasurisë me anë të veprimeve kriminale. Nëpërmjet kësaj metode janë mbledhur një mori faktesh lidhur me rastet konkrete të kriminalitetit të organizuar, të cilat kanë një rëndësi të veçantë për ndriçimin dhe studimin e kësaj dukurie, si dhe për përcaktimin e llojit dhe masën e sanksionit penal me qëllim të luftimit dhe parandalimit të tij.

Në këtë studim, përmes metodes statistikore kriminalitetin e organizuar e kemi trajtuar si dukuri aktuale e të shoqërisë dhe përdorimi i kësaj metode ka qenë ndër më të përshtatshmet për mbledhjen e shumë të dhënave mbi paraqitjen e kriminalitetit të organizuar, sekuestrimin e drogave dhe shkatërrimin apo neutralizimin e grupeve kriminale. Aplikimi i kësaj metode është bazuar në studimin dhe analizimin e evidencave të Shërbimit Policor të Kosovës dhe Agjensioni për menagjimin e pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara. Përmes kësaj metode është përcjellë dinamika e përhapjes së kriminalitetit të organizuar gjatë periudhës kohore 2016 – 2018 në territorin e Republikës së Kosovës.

Bazuar në kërkesat për të përmbushur qëllimin e këtij punimi është përdorur edhe metoda juridike me qëllim të paraqitjes së legjilacioneve dhe akteve tjera ligjore e trajtojnë këtë fushë dhe të cilat ndikojnë në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit.

5. PREZENTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

Kriminaliteti i organizuar trajtohet si një veprimtari e organizuar e aktiviteteve kriminale të grupeve me së paku prej tre personave dhe këto organizata kanë qenë fillimisht të formuara nga italianët të cilët veprimtarin e tyre e kanë vazhduar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës sipas strukturave të mafias siciliane. Institucionet e ndryshme ndërkombëtare, të OKB-së, Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian, qendra të ndryshme kërkimore dhe shkencore të pavarura kryejnë studime të krimit të organizuar dhe matin format dhe mënyrat e paraqitjes së këtij fenomeni. Edhe pse shumë autorë dhe institucione të tjera janë marrur me çështjen e kriminalitetit të organizuar, duke cekur edhe elementet përbërse të tij është e pamundur që deri sot të kemi një definim të saktë për kriminalitetin e organizuar. Kriminaliteti i organizuar ka ndryshuar dukshëm së bashku me tiparet dhe format e ndryshme të cilat aplikohen nga organizata kriminale. Aktivitetet e këtyre grupeve kriminale kanë filluar të ndryshohen dhe të shfaqen në forma të ndryshme dhe kryesisht veprimtarin e tyre e shtrijnë në vendet e Evropës Perëndimore dhe se karakterizohen nga mënyra e veprimit të tyre. Tipar i rëndësishëm është edhe agresiviteti i kryesve të veprave penale dhe ndëshkimet e rrepta brenda grupit. Karakteristikë e krimit të organizuar janë edhe format e paraqitjes së tij. Këto forma ndryshojnë varësisht nga konteksti i rrethanave politike dhe shoqërore brenda shteteve të caktuara, sepse një formë e krimit të organizuar mund të jetë e pranishme në një shtet, ndërsa më pak në shtetin tjetër. Gjatë këtij punimi janë trajtuar dy nga format e kriminalitetit të organizuar të cilat janë prezente në çdo vend duke përfshirë edhe Kosovën, dhe ato janë: kontrabandimin me narkotikë dhe kriminaliteti kompjuterik. Këto dy forma të kriminalitetit të organizuar paraqesin rrezik për shoqërinë. Në Kosovë, faktorët të cilët ndikojnë në paraqitjen e krimit të organizuar janë gjendja ekonomike dhe ngecja e zhvillimit ekonomik dhe kjo vjen si rezultat i pasojës së trashëgimis së një ekonomie të shkatërruar pas luftes, pra këto forma paraqiten si pasojë e procesit të transicionit dhe rrethanave të caktuara politike. Mirëpo, egziston edhe një numër i madh i legjislacioneve të cilat merren me parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit të organizuar në përgjithësi dhe janë në përputhje me të gjitha standardet e kërkuara ndërkombëtare. Zbatimi i legjislacionit penal në praktikë, veçanërisht sanksionet penale, gjykatat kanë aplikuar rrethanat lehtësuese dhe kanë shqiptuar dënime mjaft të ulta ndaj kryesëve të veprave penale në lidhje me kriminalitetin e organizuar në Kosovë. Ndërsa, aktgjykimet më të shpeshta të shqiptuara për kryesit e veprave penale të kryera në formë të krimit të organizuar janë për kontrabandën me narkotikë

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Duke trajtuar kriminalitetin e organizuar në aspekte të ndryshme, kemi bërë përpjekje që gjatë shqyrtimit të kriminalitetit të organizuar në kuadër të pjesëve përbërse të nxjerrim përfundime dhe rekomandime në lidhje me kuptimin, zbulimin dhe luftimin e kësaj dukuri. Andaj, gjatë këtij punimi është trajtuar kriminaliteti i organizuar sipas legjislacioneve në Kosovë dhe legjislacioneve të tjera ndërkombëtare.

Duke u mbështetur në burimet e nevojshme trajtuam nocionin e kriminalitetit të organizuar, në mënyrë që të kuptojmë terminologjinë dhe përmbajtjen e kriminalitetit të organizuar, shtjelluam historikun dhe zanafillën e kësaj dukurie me qëllim që të kuptojmë zhvillimin i cili ka ndodhur më këtë formë të sjelljeve kriminale në periudha të ndryshme kohore, pasi që njohja e të drejtave të vendeve tjera ndihmon në procesin e hartimit të legjislacionit dhe të avancimit të së drejtës në vendin tonë. Gjithashtu, është e rëndësishme që të arrihet identifikimi i kryesve të veprave penale të kryera në formë të krimit të organizuar dhe institucionet shtetërore të merren me rehabilitimin dhe ri-socializimin e tyre. Gjykatat dhe mekanizmat tjera insitucionale duhet punuar në përmisimin e kuadrit ligjor dhe hartimin e politikave të reja, në harmonizim me legjislacionin e BE-së, me qëllim të luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit të organizuar.

Për më tepër, gjatë këtij punimi janë shtjelluar edhe hapat që duhet të ndërmerren nga shteti për të ndërtuar një sistem më të avancuar dhe bashkëkohor për parandalimin e krimit. Të investosh sot në parandalimin e kriminalitetit është një siguri dhe investim strategjik për shtetin, pasi që studimet kanë treguar se të parandalosh sot, do të thotë të kursesh në shërbime apo institucione që do të duhen për të kuruar pasojat nesër.

Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të suksesshëm të krimit të organizuar, i cili ka shqetësuar çdo shoqëri, veçanarisht në Kosovë, kemi formuluar edhe këto rekomandime:

- Ofrimi i mbështetjes dhe fuqizimit të institucioneve ekzistuese në Republikën e Kosovës për luftimin e kriminalitetit të organizuar në Kosovë;
- Kompletimi i legjislacionit të Republikës së Kosovës me nxjerrjen e ligjit anti-mafia, si një nga ligjet më të rëndësishme për luftimin e kësaj dukurie kriminale;
- Gatishmëria dhe vullneti politik për luftimin e kriminalitetit të organizuar;
- Profesionalizmi i kuadrove të cilat merren me hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e kryesve të veprave penale si formë e kriminalitetit të organizuar
- Trajtimi primar i rasteve të veprave penale në formë të krimit të organizuar , nga policia, prokurori i shtetit dhe gjykata të cilat paraqesin rrezikshmëri të vazhdueshme.

7. REFERENCAT

2012. *Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit 2012 – 2017*. Prishtinë.

Available at: <https://www.interpol.int/en/Crimes/Organized-crime>

Dictionary, F. F., 2012. *Farlex Financial Dictionary*. s.l.:Farlex.

Elezi, I., 1995. *E drejta penale*. Tirane.

Gashi, R., 2014. *Krimi i organizuar*. Prishtinë: Xprint.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2017).

Halili, R., 2016. *Kriminologjia*. Prishtinë.

<https://rm.coe.int/16806ef3d4>, 2006. [Online].

Kodi Penal i Republikës së Kosovës (2013).

Kodi Penal i Republikës së Kosovës (2019).

Konventa e Këshillit të Evropës mbi kriminalitetin kompjuterik (2001).

Latifi, V., 2011. *Kriminalistika*. Prishtinë.

Latifi, V., 2012. *Politika e luftimit të kriminalitetit*. Prishtinë.

Latifi, V., 2013. *Politika kriminale*. Prishtinë.

Latifi, V., 2014. *Kriminalistika*. Prishtinë.

Përmbledhje e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ligjore Ndërkombëtare (2016).

Poda, Z., 1998. *Krimi i Organizuar*. Tirane.

Raporti Vjetor i Policisë së Kosovës (2016).

Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër narkotikëve dhe plani i veprimit (2012 – 2017).

Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit (2012-2017).

Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalim të krimit dhe plani i veprimit (2013-2017).

Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë (2015 – 2019).

Strategjia kundër korrupsionit (2013-2017).

Strategjia shtetërore kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit (2018-2022).

Strategjia Shtetërore për sigurin kibernetike dhe plani i veprimit (2016-2019).

Veton Vula, M. A., 2018. *Krimi Kompjuterik*. Prishtinë.

Vula, V., 2013. *Kriminalitet i organizuar*. Prishtinë.